



RAPORT MONITORIMI

VJETOR

“Lufta ndaj korrupsionit, drogës dhe krimit të organizuar”

Û

Tiranë, Tetor 2021



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Përgatiti:

Znj. Ardita Kolmarku, Eksperte Ligjore e Jashtme

Kontribuan në hartimin e raportit:

1. Znj. Bleona Metushi, Gazetare, Eksperte e Jashtme
2. Enkeleid Llanaj, gazetar, Ekspert i Jashtëm

Rishikoi:

Znj. Anila Hoxhaj, Gazetare, Drejtore Ekzekutive, Qendra “FOL”

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Qendra “FOL”

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Qendra “FOL” në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rruga “Pjetër Budi” , godina numër 69, Tiranë

E-mail: gendrafol@gmail.com

Telefon: +355682082888

Përmbajtja e Punimit

Hyrje	
Përmbledhje Ekzekutive	
KREU I	
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT	
1. Trendi i ndërmarrjes së akteve korruptive në kohë	
1.1. Përfaqësuesit e autoriteteve publike dhe subjektet fizike të përfshirë në akte korruptive	
1.2. Statusi procedural i shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kategorinë “Korrupsion”	
2. “Shpërdorimi i detyrës” tashmë një fenomen	
2.1. Mungesa e kompetencës së SPAK dhe vendimmarrjet e mosfillimit	
2.2. Pushimi i akuzës ose çështjes penale	
2.3. Trendi i masave të sigurimit	
2.3.1. Masa e sigurimit personal “arrest në burg”	
2.3.2. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi”	
2.3.3. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”	
2.3.4. Masa ndaluese “pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”	
3. Krimet Zgjedhore	
3.1. Fenomeni i korrupsionit aktiv në zgjedhjet parlamentare Prill 2021	
3.2. Subjektet proaktive depozitues të kallëzimeve penale	
3.3. Shpallja e moskompetencës nga SPAK dhe mosfillimi i procedimeve penale	
3.4. Analiza e fashikujve hetimorë dhe gjyqësorë të disa prej çështjeve “pikante”	
3.4.1. Sa kushton një akt korruptiv?	
4. Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike apo zgjedhore	
5. Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën	
6. Korrupsioni nga ish-përfaqësues dhe përfaqësues të sistemit të drejtësisë	
7. Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, ose i funksionarëve të lartë shtetërorë apo të zgjedhurve vendorë dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj tyre	
8. Shkelja e barazisë në tendera	
9. Përfitimi i paligjshëm i interesave dhe fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	
KREU II	

LUFTA KUNDËR DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR	
1. Lufta kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar	
2. Përfshirja e të rinjve dhe të miturve kërkon reflektim.....	
3. Figurat e veprave penale të konsumuara në fushën e drogërave	
3.1. Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike sipas nenit 283 K.P.	
3.1.1. Vendimmarrjet e mosfillimit dhe kërkesat për pushimin e çështjeve nga ana e Prokurorisë	
3.1.2. Trendi i masave të sigurimit.....	
3.2. Referimi i shtetasve sipas nenit 283/1 Kodit Penal.....	
3.2.1. Vendimmarrjet e mosfillimit dhe kërkesat për pushimin e çështjes.....	
3.2.2. Trendi i masës së sigurimit “arrest në burg”	
3.2.3. Trendi i masës së sigurimit “arrest në shtëpi”	
3.2.4. Masa më e përdorur ajo e ‘detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’	
3.3. Referimi i shtetasve të dyshuar për mbajtjen, shitjen ose shpërndarjen e lëndës narkotike në formën e bashkëpunimit ose më shumë se një herë, sipas nenit 283/2 K.P.	
3.3.1. Masa e sigurimit “arrest në burg”	
3.3.2. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”	
3.4. “Trafikimi i narkotikëve” dhe “Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës”	
3.4.1. Masa e sigurimit “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi”	
3.4.2. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”	
3.5. “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “organizata kriminale”	
3.5.1. Masa e sigurimit “arrest në burg”	
3.5.2. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”	
3.5.3. Organizata kriminale	
3.6. “Përshtatja e lokalit për përdorim droge” dhe “nxitja për përdorimin e drogës”	
Rekomandime	

Hyrje

Ekspertët e Qendrës “FOL” nga muaji Nëntor 2020 kanë monitoruar proaktivisht procesin e procedimeve penale të regjistruara pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Monitorimi është shtrirë edhe në shqyrtimin e këtyre procedimeve penale pranë sistemit gjyqësor. Ekspertët kanë informuar publikun në mënyrë periodike 3 mujore¹, 6 mujore² dhe një analizë të veçantë mbi fenomenin e korrupsionit me vlera të ulëta monetare, të ofruara nga ana e qytetarëve.³

Veprimtaria e ekspertëve u bazua në një metodologji të specifikuar monitorimi që u reflektua në ngritjen e një databaze, bazuar në domosdoshmërinë e reflektimit të të dhënave mbi kategorinë e figurave të veprave penale që janë pjesë e Kreut VIII “Krime kundër autoritetit të shtetit”, Seksioni III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, të cilat janë reflektuar nga ana e ligjvënësit në dispozita materiale penale nenet 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 285/a, 285/b dhe 286 të Kodit Penal; si dhe figurat e veprave penale që kanë si qëllim goditjen e fenomenit të korrupsionit të kryer nga funksionarë publikë, të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cënimin e interesit publik dhe integritetit institucional e shtetëror pjesë e krerëve III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, VIII “Krime kundër autoritetit të shtetit” dhe IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, pjesë e seksioneve I,⁴ II⁵ dhe III⁶ të Kodit Penal. Më konkretisht në kategorinë e dytë objekt monitorimi përfshihen nenet 135, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 256, 257,

¹ Raport Monitorimi “Veprimtaria dhe vigjilenca e institucioneve në luftën ndaj lëndëve narkotike” Nëntor 2020 – Janar 2021. Link: <https://fol.org.al/ep-content/uploads/2021/02/Raport-i-ndermjetem-nentor-2020-janar-2021.pdf>

² Raport Studimor “Veprat penale të korrupsionit, formave të shpërdorimit të detyrës dhe lufta ndaj lëndëve narkotike” Nëntor 2020 – Prill 2021. Link: <https://fol.org.al/ep-content/uploads/2021/05/17.05.2021-Raport-Studimor-6-mujor-final-converted-1.pdf>

³ “Fenomeni i korrupsionit nuk njeh limite”. Link: <https://fol.org.al/fenomeni-i-korrupsionit-nuk-njeh-limite/>

⁴ Seksioni “Vjedhja e pasurisë”

⁵ Seksioni “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”

⁶ Seksioni “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”

257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 313, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e K.Penal.⁷ Gjatë monitorimit nga ana e ekspertëve u vërejt me interes shtrirja e fushëveprimit edhe në veprat penale të realizuara nga ana e eksponentëve të caktuar kriminalë, bazuar në nenin 333/a “Grup i strukturuar kriminal” të cilët u proceduan penalisht për kryerjen e veprave penale në rrethana cilësuese.

Grumbullimi i të dhënave rreth këtyre kategorive të veprave penale u bë i mundur në kuadër të hulumtimit të praktikave hetimore dhe gjyqësore, duke përfshirë fazën e hetimeve paraprake deri në gjykimin pranë Gjykatës së Lartë, e cila shqyrton ligjshmërinë e vendimmarrjeve respektive në dhomë këshillimi, njëson dhe zhvillon praktikën gjyqësore si dhe kur është rasti e ndryshon atë, sipas kompetencave të parashikuara në nenin 14/a të K.Pr.Penale.

Me qëllim reflektimin objektiv të të dhënave të grumbulluara, databaza e ngritur nga ana e Qendrës “FOL” ka shërbyer si një arkivë e mirëfilltë dhe e strukturuar informacioni, e cila jemi të bindur se do të shërbejë pozitivisht dhe do të lehtësojë punën e mëtejshme të studiuesve të së drejtës, ekspertëve të fushës dhe të interesuarve për të hulumtuar mbi këto kategori të veprave penale.⁸ Në këtë databazë të aksesueshme online nga ana e publikut, ekspertët kanë reflektuar çdo rrethanë faktike të shprehur në vendimmarrjet gjyqësore, si dhe në vendimmarrjet e disponuara nga organi procedues i akuzës dhe Policia e Shtetit. Në këtë platformë online kategoria e veprave për të cilat është vendosur mos fillimi apo pushimi I procedimit penal, të dhënat e gjurmara ndaj shtetasve të dyshuar apo të referuar nga Policia e Tiranës nuk janë bërë publike, por për çdo interesim të dhënash për këtë kategori duke ruajtur të dhënat personale, mund të kontaktoni Qendrën FOL

⁷ Disa prej disa dispozitave të sipërcituara në zbatim të nenit 75/a K.Pr.P. janë kompetencë e SPAK (me ndryshimet e ligjit nr. 41/2021). Ndërkohë figurat e veprave penale të parashikuara në kategorinë e I-rë objekt monitorimi, të cilat kanë si qëllim luftën kundër drogës dhe krimit të organizuar, përfshihen nën kompetencën lëndore të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në rast se subjekte të realizimit të këtyre veprave penale janë organizata kriminale, grup i strukturuar kriminal, organizata terroriste apo banda e armatosur, sipas përcaktimeve në nenet 28, 333, 333/a, dhe 334 të Kodit Penal.

⁸ <https://webapp.fol.org.al/publik.php>

Qendra “FOL” dëshiron të falenderojë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, institucionet kyçe që luajtën një rol të rëndësishëm në implementimin e projektit “Fol për Drejtësinë” si Policia e Shtetit, Prokuroritë pranë të dyja shkallëve të gjykit Tiranë dhe përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatave penale të të gjitha shkallëve të gjykit në Tiranë, si dhe ekspertët e angazhuar në terren në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë monitorimit 1 vjeçar të realizuar, ekspertët e Qendrës “FOL” kanë arritur të identifikojnë disa gjetje kyçe, të cilat reflektohen në këtë seksion të përmbledhjes ekzekutive në versionin e konkluzioneve paraprahe.

➤ Kategoria e veprave penale në fushën e korrupsionit:

1. Janë monitoruar në total 578 raste të përfshira në këtë kategori ose rreth 30% e numrit total të të gjitha çështjeve të shqyrtuara, të cilat përfshijnë përveç kategorisë së korrupsionit, edhe kategorinë e veprave penale në fushën e drogës dhe krimit të organizuar. Më konkretisht 76 raste ose rreth 13% të regjistruara në vitin 2020, ndërkohë 502 raste ose rreth 87% janë regjistruar në vitin 2021.
2. Sa i përket të dhënave statistikore të monitoruara gjatë vitit 2021 rezulton se muaji Korrik 2021 (97 raste) mban vendin e parë sa i përket periudhës kohore gjatë së cilës është regjistruar numri më i lartë i materialeve në fushën e korrupsionit, ndjekur më pas nga muaji Prill 2021 (68 raste) dhe Shkurt 2021 (63 raste). Një dinamikë e tillë statistikore nuk është e çuditshme, pasi përkon me operacione të rëndësishme të ndërmarra nga ana e SPAK, ndër të cilat përmendim arrestimin e 18 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të akuzuar për korrupsion përmes “shkeljes së barazisë në tendera dhe shpërdorimit të detyrës”.
3. Nga 578 raste të korrupsionit të referuara pranë organeve proceduese, rezulton se numrin më të lartë të subjekteve të përfshira e mbajnë zyrtarët dhe ish zyrtarët e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorive Rajonale Rurale dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Aktet korruptive të dyshuara si të ndërmarra nga ana e këtyre subjekteve, duket se konkurojnë me korrupsionin në sistemin gjyqësor, i dokumentuar në masën 26%.
4. Konstatohet se referimi i shtetasve në gjendje të lirë është statusi procedural më i përdorur, konkretisht në 446 raste ose rreth 77%. Ndërkohë arrestimi i shtetasve në flagrancë ose në ekzekutim të masave të sigurimit personal të vendosura në mungesë të tyre rezulton të jetë ekzekutuar në 132 raste ose rreth 23%.

5. Vlerësohen disa faktorë ndikues siç është politika penale humaniste drejt tendencës për ekzekutimin në nivele më të reduktuara të masave të sigurimit; niveli i lartë i pandëshkueshmërisë në rastin e veprave penale në fushën e korrupsionit; mungesa e kapaciteteve të autoriteteve proceduese për të ngritur akuzën mbi bazën e indicieve dhe provave përtej çdo dyshimi të arsyeshëm; ose perfeksionimi i mënyrës së kryerjes së veprës penale nga ana e ish-funksionarëve apo funksionarëve aktualë të lartë në institucione të nivelit qendror apo vendor, të cilët e shndërrojnë në të pamundur arritjen e objektivit për vënien para përgjegjësisë të autorit konkret.
6. Shpërdorimi i detyrës i cili përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, në përputhje me parashikimin e nenit 248 K.P. është monitoruar nga ana e ekspertëve në 396 raste ose rreth 69%, duke krijuar përshtypjen se kjo vepër penale tashmë përbën një ndër degëzimet kryesore në kategorinë e veprave penale në fushën e korrupsionit. Qytetarët tashmë janë ndërgjegjësuar mbi elementët e kësaj vepre penale duke u shndërruar në subjekte kallëzues në 144 raste, ndërkohë që rastet e tjera rezultojnë të jenë kallëzuar nga subjekte të ndryshme.
7. Në 92 raste ose rreth 23%, qytetarët kanë zgjedhur t'i drejtohen SPAK, por ky i fundit ka shpallur moskompetencën duke i referuar çështjet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor për kompetencë. Për 175 raste ose 41% organi i akuzës vendor ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që asnjë prej këtyre vendimmarrjeve nuk është ankimuar në gjykatë. Vetëm në 3 raste rezulton se organi i akuzës ka kërkuar pushimin e akuzës ose çështjes, bazuar në kompetencën dhënë sipas nenit 329/a K.Pr.P.
8. Në 21 raste ose rreth 5% rezulton që përfaqësuesit e organit të akuzës të kenë kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, por vetëm në 17 nga këto raste rezulton që kërkesa e prokurorit për caktimin e kësaj mase të jetë aprovuar nga ana e Gjykatës. Por kjo masë siguri personal është ruajtur deri në Gjykatën e Apelit vetëm për 12 raste, pasi 5 rastet e tjera janë shoqëruar me zëvendësimin e masës së sigurimit personal, duke prodhuar lehtësim të pozitës së tyre procedurale dhe zbutje të masës së sigurimit fillestare.

9. Në 4 raste rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, duke caktuar në 1 rast masën e sigurimit “arrest në shtëpi” dhe në 3 rastet e tjera “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
10. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 K.Pr.P. është kërkuar nga ana e organit të akuzës në 11 raste. Në 10 raste kjo kërkesë është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit në 9 raste.
11. Përfaqësuesit e organit procedues për 8 raste të dyshuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kjo kërkesë është aprovuar në të gjitha rastet nga Gjykata e Shkallës së Parë, ndërkohë që vetëm në 1 rast ka përfunduar shqyrtimi në Gjykatën e Apelit duke lënë në fuqi të njëjtën masë siguri personal.
12. Masa ndaluese e “pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” rezulton të jetë kërkuar nga ana e prokurorit vetëm në një rast, njëkohësisht me kërkesën për gjykim të depozituar prej tij në Gjykatë. Ky rast lidhet me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Ministrisë së Brendshme, të dyshuar si të përfshirë në tejkalimin e kompetencave të tyre gjatë shqyrtimit të procesit të prokurimit publik për mjetet e emergjencës gjatë Covid-19.
13. Deri në muajin Shtator 2021, sipas të dhënave zyrtare të bëra publike nga SPAK rezulton se 149 materiale janë regjistruar, ku pjesa më e madhe e materialeve rezulton të jenë referuar nga ana e subjekteve politike, përkatësisht 89 raste ose rreth 60% e tyre. Subjektet elektorale nuk rezultojnë të jenë të vetmet që kanë referuar çështje pranë kësaj strukture, pasi rol proaktiv rezulton të kenë luajtur dhe Drejtoritë Vendore të Policive, institucioni i Presidentit, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, SHKBB, OPGJ, shtetasit dhe kryesisht vetë SPAK.
14. Nga 149 materialet e referuara pranë SPAK, në 60 raste ose rreth 40% e rasteve, Prokuroria ka regjistruar procedimin penal, ndërkohë që në 20 raste (ose rreth 13%) organi procedues ka vendosur bazuar në nenet 290 e vijues K.Pr.P. mosfillimin e procedimit penal.

Procedimet e regjistruara nga ana e SPAK rezultojnë të jenë në pjesën më të madhe në fazën e hetimeve paraprake, përkatësisht 36 raste ose rreth 58% e procedimeve të regjistruara. Ndërkohë që kërkesë për pushim është depozituar nga ana e prokurorit të çështjes vetëm në 1 rast.

15. 19 procedime penale janë transferuar, si rrjedhojë e shpalljes së moskompetencës, ku numrin më të lartë të rasteve të transferuara e vërejmë drejt Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Lushnjë. Krimi zgjedhor në këto zgjedhje parlamentare duket se nuk ka njohur ndasi territoriale, pasi është shtrirë në disa qarqe të vendit si Durrës, Tiranë, Vlorë, Dibër etj.
16. Sa i përket veprës penale të “përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” ekspertët kanë monitoruar 13 raste, ku subjektet referues rezultojnë Policia, shtetas, institucioni i Presidentit, Prokuroria e Posaçme SPAK dhe subjekti politik opozitar PD. Më konkretisht në 4 prej këtyre rasteve ose rreth 31%, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që për rastet e tjera vijnë ende ndërmarrja e hetimeve. Në 5 raste për shkak të veprës penale, SPAK ka shpallur moskompetencën duke ja transferuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.
17. Nga rreth 578 rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë periudhës 1 vjeçare, qytetarët zgjedhin të paguajnë vlera monetare duke filluar nga 10 euro ose 1000 lekë (të reja) për të përfituar nga paligjshmëria. Vetëm në 3 raste, shtetasit e akuzuar për korrupsion aktiv ndaj funksionarëve publikë kanë pranuar kushtet e marrëveshjes së fajësisë me organin procedues, duke përfituar pezullimin e dënimit me burgim dhe konvertimin e tij në shërbim prove ose punë në interes publik.
18. Funksionarët publikë apo shtetas të ndryshëm, të cilët janë ngarkuar me administrimin ose ruajtjen e pasurisë së caktuar, në 30 raste kanë zgjedhur që të përfitojnë nga pozicioni i tyre dhe ta përvetësojnë pasurinë në mënyrë të padrejtë. 25 prej tyre ose rreth 83% janë proceduar në gjendje të lirë, ndërsa 5 raste ose 17% janë arrestuar në flagrancë. Në 6 raste organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë në 1 rast është kërkuar

pranë gjyqtarit të seancës paraprahe pushimi i çështjes. Masa e sigurimit “arrest në burg” është kërkuar dhe caktuar në 4 raste, por Gjykata e Apelit e ka zbutur masën për 2 prej tyre.

19. 11 raste ose rreth 2% e numrit total të rasteve të monitoruara në kategorinë e korrupsionit, janë monitoruar nga ana e ekspertëve të Qendrës, nën nenet 319/a, 319/ç dhe 319 K.P, korrupsion nga ish-përfaqësues ose përfaqësues aktualë të sistemit të drejtësisë (Gjykata dhe Prokuroria). Në 5 raste, që i korrespondojnë operacionit të ndërmarrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Prokuroria krahas kërkesës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ka kërkuar gjykimin e çështjes në themel.
20. 26 raste ose rreth 4.5% të numrit total të rasteve rezultojnë të dyshuar për korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike. SPAK ka vendosur mosfillimin për 3 prej këtyre rasteve. Në 12 raste është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, e cila është lënë në fuqi në të gjitha rastet nga të dy shkallët e gjykimit. Ndaj 4 shtetaseve të gjinisë femërore, Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme në të dyja shkallët e gjykimit.
21. 27 raste rezultojnë të monitoruara, ndërkohë që vetëm 15 raste ose rreth 56% konstatohen si të dyshuar për kryerjen e formës së pastër të kësaj figure të veprës penale. Në 12 raste rezulton se përfaqësuesit e prokurorisë kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme shkalla e I-rë në 11 raste, ndërkohë 1 prej rasteve është ende në proces. Gjithashtu, 6 rastet në të cilat prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” janë aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme shkalla e I-rë dhe ajo e Apelit në 5 raste.
22. Nga 6 rastet e monitoruara për përfitim të paligjshëm të interesave dhe fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë, në 2 raste konstatohet se Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Shtetasit e kallëzuar rezultojnë ish-prokurorë, ish-gjyqtarë dhe ish-anëtarë të organeve të vettingut. Gjykata e Posaçme ka vendosur masën e sekuestros ndaj një ish-gjyqtari të Gjykatës së Lartë dhe ish-gjyqtari

të Gjykatës Kushtetuese, të cilët janë shkarkuar në kuadër të procesit të vettingut.

➤ **Kategoria e veprave penale në fushën e drogës dhe krimit të organizuar:**

1. 1320 raste ose rreth 69% e numrit total të materialeve, janë monitoruar nën kategorinë e veprave penale në fushën e drogërave. 711 raste ose rreth 54% e materialeve janë adresuar pranë organeve proceduese për veprën penale të ‘prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike’ në formën e saj klasike, parashikuar nga neni 283 K.P., duke bërë që kjo të jetë dispozita më e përdorur. Konstatohet se muajt Qershor 2021 (203 raste ose rreth 15%) dhe Shtator 2021 (172 raste ose rreth 13%) janë muajt në të cilat janë ndërmarrë operacionet më të rëndësishme në fushën e luftës kundër lëndëve narkotike.
2. Nga të dhënat e monitoruara konstatohen rreth 52 raste ose rreth 4%, në të cilat personat e përfshirë janë të mitur ose të rinj, të moshave 14-23 vjeç. Mbeten shqetësim veprat penale në të cilat këto të mitur rezultojnë të përfshirë, pa u kufizuar vetëm në “prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike” (neni 283 K.P.); “kultivimi i bimëve narkotike” (neni 284 K.P) etj. Janë arrestuar në flagrancë vetëm 21 shtetas, dhe 31 prej tyre janë proceduar në gjendje të lirë. Ndaj 24 shtetasve është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për shkak të përdorimit të rregullt të lëndës narkotike dhe sasisë së vogël për përdorim vetjak.
3. Në 707 raste ose rreth 54% ekspertët kanë monitoruar materiale të referuara për “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike në formën klasike”, parashikuar nga neni 283 K.P. Janë proceduar në gjendje të lirë 68% ose rreth 478 shtetas, ndërkohë në 32% të rasteve ose rreth 229 shtetas janë proceduar në gjendje të lirë. pPër 362 raste ose rreth 51%, të shtetasve të proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, e cila nuk është ankimuar në Gjykatë.
4. Është kërkuar pushimi i çështjes në 13 raste, ku fillimisht ndaj 4 prej shtetasve është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” masë e cila është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës vetëm në 3 raste, ndërkohë në njërin prej rasteve Gjykata ka refuzuar kërkesën e

prokurorit duke caktuar ndaj shtetasit masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

5. Për 93 raste ose rreth 44% është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës në 82 raste, ndërkohë në Apel u ruajt vetëm për 40 prej tyre. Mekanizmi i gjykimit të shkurtuar duket se ka shpëtuar në disa raste shtetasit e pandehur. Punonjës policie kanë rezultuar të përfshirë në vepra penale në fushën e narkotikëve, në bashkëpunim me shtetas të tjerë të njohur për uniformat blu si përdorues dhe shitës të lëndës narkotike.
6. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është kërkuar nga ana e Prokurorisë në 19 raste, kërkesa të cilat janë aprovuar nga gjyqësori vetëm për 18 shtetas. Në 1 rast Gjykata e Apelit ka zgjedhur të zbusë masën e sigurimit duke e zëvendësuar me atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” u la në fuqi nga ana e dy shkallëve të gjykimit vetëm në 3 raste. Masa më e kërkuar nga ana e prokurorisë rezulton ajo e “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në 101 raste ose rreth 14%. Kjo masë është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, por 8 shtetas që e kanë ankimuar janë bazuar në shkaqe shëndetësore dhe familjare.
7. Të proceduar për nenin 283/1 K.P. rezultojnë 476 raste ose rreth 36% e numrit total, ku 80% e shtetasve ose 379 janë proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë, ndërkohë 97 shtetas janë arrestuar në flagrancë. Në 243 raste ose rreth 96%, konstatohet se organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që në 10 raste ose rreth 4% është depozituar kërkesë për pushimin e çështjes. Në 39 raste ose rreth 8% të numrit total, Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, por vetëm në 28 raste kjo kërkesë është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërkohë që deri në shqyrtimin e çështjes në shkallën e dytë (Apel) masa është ruajtur vetëm për 20 shtetas. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” rezulton të jetë kërkuar nga ana e organit të akuzës në 6 raste, e lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Edhe në këtë rast, masa më e përdorur është ajo e “detyrimit për t’u paraqitur në policinë

gjqësore”, e kërkuar në 48 raste por e aprovuar nga Gjykata vetëm në 46.

8. Në 32 raste konstatohet se shtetasit janë akuzuar se me veprimet e tyre kanë përmbushur elementët e kryerjes së veprës penale të mbajtjes, shitjes ose shpërndarjes së lëndës narkotike në rrethana cilësuese. 29 shtetas janë arrestuar në flagrancë, kurse 3 janë proceduar në gjendje të lirë. Në 17 raste është kërkuar caktimi i “arrestit në burg”, aprovuar në 15 raste, por zbutur nga Apeli në 6 raste. Nga 12 shtetas nën masën e “detyrimit të paraqitjes”, vetëm 3 prej tyre ankimuan masën, por Apeli i hodhi poshtë këto kërkesa.
9. 29 materiale, nga të cilat 25 për trafikimin e lëndëve narkotike dhe 4 të dyshuar për krijimin e lehtësirave për përdorimin e drogës janë monitoruar. Ndaj këtyre të fundit, masa e kërkuar dhe e caktuar është ajo e “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Sa i përket veprës penale të ‘trafikimit të lëndëve narkotike’ u konstatua se në 22 raste organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, por Apeli vetëm në 19 raste ka lënë në fuqi të njëjtën masë. Vetëm në 1 rast prokuroria ka kërkuar masën “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila nuk është pranuar nga ana e Gjykatës.
10. Për kultivimin e bimëve narkotike janë depozituar 66 materiale, ndaj 37 prej tyre është kërkuar caktimi i masës “arrest në burg”, lënë në fuqi nga Apeli vetëm për 24 raste. Në 9 raste, Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit “arrest në burg” duke e zbutur në atë të “arrestit në shtëpi”. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” rezulton të jetë kërkuar nga ana e organit të akuzës në 8 raste, por vetëm në 5 prej këtyre rasteve kjo kërkesë ka përmbushur pritshmëritë e Gjykatës. Prokuroria në 5 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kryesisht shtetasit e përfshirë në këto raste rezultojnë të bashkë-pandehur, ndërkohë që roli i tyre në realizimin e veprës penale nuk ka rezultuar nga hetimi që të ketë qenë i një niveli të tillë sa të aplikohen masa siguri më të rënda.
11. Nga monitorimi i 12 rasteve të kategorizuara si krim i organizuar, ekspertët konstatojnë se masa e sigurimit “arrest në burg” e caktuar

ndaj disa prej tyre, në rolin e krerëve nuk ka mundur të ekzekutohet për shkak se ata vijojnë në kërkim. Ngjarjet e ndodhura në vendin tonë të kategorizuara nën krimin e organizuar pasqyrojnë në praktikë lidhjet e forta shoqërore ndërmjet të bashkë-pandehurve dhe interesa të shumëfishta dypalëshe të përkthyer në formën e “ndereve”, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që respekti të vlerësohet në nivelin e duhur. Por ndërkohë në thelb të grupeve kriminale, konstatohet përdorimi në praktikë i kodeve të heshtjes, element që vërtetohet me faktin se të gjithë anëtarët e grupit të arrestuar dhe aktualisht nën ekzekutim të masës së sigurimit “arrest në burg” vijojnë të hedhin poshtë akuzat ndaj tyre, ndërkohë që rëndësi paraqet dhe instituti i ‘besës kanunore’.

KREU I


VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT

1. Trendi i ndërmarrjes së akteve korruptive në kohë

Në Indeks Global të Transparency International për Korrupsionin në Botë 2020, Shqipëria zë vendin e 104 ndër 180 vende. Ndërsa në Indeks Global 2020, të "Eorld Justice Project", për sundimin e ligjit, vendi ynë renditet në vendin e 78 ndër 128 vende të botës, me një rënie prej 4 pozicionesh në krahasim me vitin 2019 dhe në vendin e 100-të për luftën kundër korrupsionit.

Ekspertët e Qendrës "Fol" kanë monitoruar një numër të lartë të praktikave hetimore dhe gjyqësore që i korrespondojnë 578 rasteve ose rreth 30% e numrit total të të gjitha çështjeve të shqyrtuara, të cilat përfshijnë përveç kategorisë së korrupsionit, edhe kategorinë e veprave penale në fushën e drogës dhe krimit të organizuar.


Sa i përket periudhës në të cilën janë regjistruar numri më i lartë i procedimeve, ekspertët vlerësojnë se duhet të mbahet parasysh se periudha e raportimit për vitin 2020 është inicuar në muajin Nëntor, si rrjedhojë numri më i madh i procedimeve rezultojnë të regjistruara në vitin 2021. Më konkretisht 76 raste ose rreth 13% të regjistruara në vitin 2020, ndërkohë 502 raste ose rreth 87% janë regjistruar në vitin 2021.



Referuar vitit 2020, numri më i lartë i materialeve proceduese rezulton të jetë regjistruar në muajin Nëntor 2020, më konkretisht 40 raste ose rreth 53%, ndërkohë në muajin Dhjetor 2020 rezultojnë 36 raste ose rreth 47%.

Sa i përket të dhënave statistikore të monitoruara gjatë vitit 2021 rezulton se muaji Korrik 2021 (97 raste) mban vendin e parë sa i përket periudhës kohore gjatë së cilës është regjistruar numri më i lartë i materialeve në fushën e korrupsionit,


ndjekur më pas nga muaji Prill 2021 (68 raste) dhe Shkurt 2021 (63 raste). Një dinamikë e tillë statistikore nuk është e çuditshme, pasi përkon me operacione të rëndësishme të ndërmarra nga ana e SPAK, ndër të cilat përmendim arrestimin e 18 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të akuzuar për korrupsion përmes “shkeljes së barazisë në tendera dhe shpërdorimit të detyrës”. Në seksionet e mëposhtme të këtij raporti studimor, ju ftojmë të njiheni me çështje pikante që kanë “rrëmbyer” vëmendjen mediatike, referimi i të cilave e shndërroi SPAK në një institucion tepër të rëndësishëm, i cili luan një rol të rëndësishëm në besueshmërinë e publikut tek drejtësia dhe dhënien e mesazhit se pandëshkueshmëria e të fortëve është drejt fundit, duke bërë që shumë qytetarë t'i besojnë çështjet e tyre SPAK edhe për dispozita të cilat nuk janë kompetencë e kësaj strukture.



Ndër këto raste përmendim: operacionin e ndërmarrë ndaj funksionarëve dhe ish funksionarëve të implikuar në procedurën e tenderimit publik të uniformave të Policisë së Shtetit; tenderi për rehabilitimin e një ujësjellësi i cili i kushtoi Kryetarit të Bashkisë Lushnjë dhe funksionarëve të kësaj Bashkie etj. Këto operacione, të cilat erdhën si një goditje e drejtpërdrejtë e sistemit vertikal të korrupsionit që ekziston në qeverisjen qendrore dhe atë vendore në vendin tonë, në këndvështrimin e ekspertëve të Qendrës “Fol” ishin lëvizjet e duhura, suksesi i të cilave i detyrohet së tepërmi faktorit ndërkombëtar.

1.1. Përfaqësuesit e autoriteteve publike dhe subjektet fizike të përfshirë në akte korruptive

Përfaqësues të institucioneve publike si Administratorë të Njësive të Qeverisjes Vendore, Anëtarë të Njësisë së Prokurimit Publik, Agjensia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë rajonale, agjensi të posaçme pranë Ministrive të linjës, Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Barnave, ARRSH (Autoriteti Rrugor Shqiptar), OSHEE (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), punonjësit e institucioneve të ndryshme të sistemit penitenciar (burgjeve) ose atyre të Policisë së Shtetit etj., si dhe përfaqësues të subjekteve private si banka të nivelit të dytë dhe fondacione mikrofinanciare, rezultojnë të kallëzuar nga ana e shtetasve të ndryshëm fizikë si autorë të dyshuar të veprave penale në fushën e korrupsionit.




Nga 578 raste të korrupsionit të referuara pranë organeve proceduese, rezulton se numrin më të lartë të subjekteve të përfshira e mbajnë zyrtarët dhe ish zyrtarët e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorive Rajonale Rurale dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Duke qenë se këta përfaqësues me veprimet/mosveprimet e tyre cënojnë të drejtën e pronës së qytetarëve, ekspertët kanë kategorizuar këto subjekte nën të njëjtën kategori, duke përbërë 73 raste ose rreth 13%.

Ndërkohë sa i përket përfshirjes së bluzave të bardha, më konkretisht mjekëve, infermierëve të përfshirë në një sërë kallëzimesh të depozituara nga qytetarët gjatë periudhës së përballjes së vendit tonë me Covid-19 dhe funksionarëve të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ekspertët kanë monitoruar rreth 17 raste ose rreth 3%. Përfaqësuesit e administratës vendore, siç janë krerë dhe ish-krerë të Bashkive dhe Njësive Administrative Vendore rezultojnë të jenë kallëzuar penalisht nga ana e shtetasve në rreth 42 raste ose rreth 7.3% të rasteve. Përfaqësuesit e uniformave blu, përkatësisht të Policisë së Burgjeve dhe Policisë së Shtetit rezultojnë subjekte të veprave penale në fushën e korrupsionit në 41 raste ose rreth 7%. Punonjësit e bankave të nivelit të dytë janë kallëzuar penalisht në 8 raste, ndërkohë që konstatohet se këta shtetas janë kallëzuar penalisht për veprat penale të “shpërdorimit të detyrës” dhe “vjedhjes së kryer duke shpërdoruar detyrën”. Sa i përket funksionarëve të cilët shkaktuan grevën e parë në sektorin publik, përkatësisht në fushën e aviacionit ajror, konstatohet se në 7 raste është depozituar kallëzim penal në organin e akuzës, ndërkohë që vendimmarrja e organit të akuzës rezulton e ndryshme për funksionarë të ndryshëm të përfshirë në të njëjtën ngjarje. Gjithashtu, sa i përket subjekteve përfaqësues dhe ish-përfaqësues të sistemit të drejtësisë, në rolin prokuror, gjyqtarë, avokatë, ekspertë etj., konstatohet se numri i kallëzimeve është i konsiderueshëm në masën 50 raste ose rreth 9%. Për shkak të rëndësisë që disa prej këtyre subjekteve, pjesë e kategorive të sipërcituara përbëjnë për publikun, ekspertët kanë zgjedhur të ndajnë me publikun rrethanat faktike dhe qasjen e përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë penale në mënyrë të kategorizuar në seksionet e mëposhtme të këtij raporti. Ndërkohë, rëndësia që në muajt e fundit kanë marrë procedurat e prokurimit, respektimi i procedurave të rregullta me qëllim garantimin e konkurrencës së ndershme në procesin e tenderimeve publike, ekspertët kanë identifikuar në 4 raste depozitimin e kallëzimeve pranë organit procedues.

Ekspertët vlerësojnë se të dhënat e sipërcituara në aspektin statistikor duhet të analizohen nga ana e publikut në raport me faktin se funksionarët dhe ish-funksionarët e autoriteteve publike ka pasur raste që janë përfshirë në veprime të cilat bien në fushë-veprimin e disa

kategorive, psh: në rastin e përfaqësuesit të një Njësie Administrative, rezulton se përfshirja e tij ka qenë në fushën e tenderave, por dhe ndikimit në prokurimet publike, duke passjellë në aspektin ligjor një konkurim ndërmjet figurave të ndryshme të veprave penale. Nisur nga kjo analizë lineare, ekspertët kanë përzgjedhur reflektimin e të dhënave statistikore sipas kategorive për secilën figurë të veprës penale.

1.2. Statusi procedural i shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kategorinë “Korrupsion”



Konstatohet se referimi i shtetasve në gjendje të lirë është statusi procedural më i përdorur, konkretisht në 446 raste ose rreth 77%. Ndërkohë arrestimi i shtetasve në flagrancë ose në ekzekutim të masave të sigurimit personal të dhëna

në mungesë të tyre rezulton të jetë ekzekutuar në 132 raste ose rreth 23%. Të dhëna statistikore të kësaj natyre nxisin në analizimin e disa faktorëve ndikues siç është politika penale humaniste drejt tendencës për ekzekutimin në nivele më të reduktuara të masave të sigurimit; niveli i lartë i pandëshkueshmërisë në rastin e veprave penale në fushën e korrupsionit; mungesa e kapaciteteve të autoriteteve proceduese për të ngritur akuzën mbi bazën e indicieve dhe provave përtej çdo dyshimi të arsyeshëm; ose perfeksionimi i mënyrës së kryerjes së veprës penale nga ana e ish-funksionarëve apo funksionarëve aktualë të lartë në institucione të nivelit qendror apo vendor, të cilët e shndërrojnë në të pamundur arritjen e objektivit për vënien para përgjegjësisë të autorit konkret.

2. “Shpërdorimi i detyrës” tashmë një fenomen

Shpërdorimi i detyrës i cili përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës, në përputhje me parashikimin e nenit 248 K.P. është monitoruar nga ana e ekspertëve në 396 raste ose rreth 69%, duke krijuar përshtypjen se kjo vepër penale tashmë përbën një ndër degëzimet kryesore në kategorinë e veprave penale në fushën e korrupsionit. Qytetarët tashmë janë ndërgjegjësuar mbi elementët e kësaj vepre penale duke u shndërruar në subjekte kallëzues në 144 raste, ndërkohë që rastet e tjera rezultojnë të jenë kallëzuar nga subjekte të ndryshme si Policia Vendore, shtetas të ndodhur në kushtet e privimit të lirisë, përfaqësues të autoriteteve publike si Urdhëri i Stomatologut, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, organet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë si KLP etj.

2.1. Mungesa e kompetencës së SPAK dhe vendimmarrjet e mosfillimit

Në 92 raste ose rreth 23%, qytetarët kanë zgjedhur t’i drejtohen SPAK, por ky i fundit ka shpallur moskompetencën duke i referuar çështjet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor për kompetencë. Për 175 raste ose 41% organi i akuzës vendor ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që asnjë prej këtyre vendimmarrjeve nuk është ankimuar në gjykatë.

Ekspertët kanë konstatuar raste tepër interesante ku të kallëzuar rezultojnë prokurorë dhe/ose oficerë policie, gjyqtarë, përfaqësues të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përfaqësues të Ministrive ose punonjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës etj.

Në një rast shtetasi i paraburgosur depozitoi kallëzim penal ndaj një prokuroreje, duke pretenduar se kjo e fundit ka shpërdoruar detyrën dhe ka filluar në mënyrë të paligjshme ndjekjen penale⁹. Fillimisht kallëzimi u depozitua në SPAK, por ky i fundit shpalli moskompetencën. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë vendosi mosfillimin e procedimit penal, me argumentimin se i paraburgosuri ka përdorur identitetin e vëllait të tij për të depozituar kallëzimin penal,

⁹ Neni 313 K.P.

ndërkohë që vëllai i tij nuk rezultonte në territorin e RSH në kohën e deponimit. Në vendimmarrjen e mosfillimit konkludohet se veprimet e Prokurores kanë qenë të drejta dhe që akuza në ngarkim të shtetasit është vërtetuar.

Në një tjetër çështje rezulton se Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit kallëzoi në SPAK Kryeministrin e RSH, kryetarin e Bashkisë dhe disa avokatë, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 244 K.P. “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, 245 K.P. “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”, 245/1 K.P. “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” etj. Sipas kallëzimit të depozituar, avokatët nën ndikimin e funksionarëve të lartë shtetërorë, përfshirë kreun e Qeverisë kanë ngritur një padi korruptive pranë Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë, me qëllim legjitimin e veprimeve apo mosveprimeve që lidhen direkt me prishjen e Teatrit Kombëtar më datë 17 maj 2020 si dhe hapjen e rrugës për fillimin e punimeve për ndërtimin e Teatrit të Ri.

Një qytetar, dikur shofer i Kryetarit të Komunës Ishëm, u caktua nga ana e Gjykatës në cilësinë e kujdestarit ligjor të hallës së tij, e cila ishte person me paaftësi fizike për të lëvizur. Në kohën e ushtrimit të funksionit pranë Kryetarit të Komunës, kallëzuesi pretendon se Kryetari i ka propozuar shitjen e një hapësire të pasurisë së paluajtshme në pronësi të hallës. Ndërkohë që kontrata e nënshkruar ishte realizuar mbi bazën e një çmimi fiktiv, kryetari i Komunës në asnjë rast nuk kishte realizuar shlyerjen e plotë të vlerës së pasurisë. Kallëzimet e depozituara në prokurori nga ana e shtetasit nuk kishin qenë të suksesshme, ndërkohë që vendimmarrjet për mosfillimin e procedimit penal liheshin në fuqi edhe nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor. Ndodhur në këto kushte, kallëzuesi zgjodhi që t’i drejtohej seksionit civil duke kërkuar pavlefshmërinë e veprimit juridik të kryer, por gjyqtarja e kallëzuar e zvarriti çështjen në mënyrë të paarsyeshme për rreth 1 vit. Ky kallëzim i cili u depozitua fillimisht në SPAK, u përcoll nga ky i fundit për kompetencë pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal,

Prokuroria argumentoi se “*pretendimet e kallëzuesit janë në formën e pakënaqësisë ndaj vendimmarrjeve gjyqësore në rastin e çështjeve penale, pushimit të procedimit penal po ashtu edhe ndaj gjyqtarëve që kanë marrë në shqyrtim çështjen civile*”.

Në rastin objekt analize, por nisur dhe nga rrethanat mbi bazën e të cilave janë depozituar disa kallëzime nga ana e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, ekspertët e Qendrës “Fol” vlerësojnë se përfaqësuesit e organit të akuzës duhet t’i kushtojnë rëndësi argumentimit të vendimmarrjeve të mosfillimit të çështjes apo procedimit penal. Zvarritja e çështjeve të ndryshme nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, e cila mund të jetë ndikuar edhe nga dinamika e reduktuar e procesit të vettingut dhe vakancat e krijuara për një kohë të gjatë në sistemin gjyqësor, duhet të jenë proporcionale duke mos prodhuar çënim në thelb të së drejtës. Dhënia e drejtësisë brenda afateve të arsyeshme kohore, është një nga komponentët thelbësorë të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 6 KEDNJ. Për këtë qëllim, ekspertët vlerësojnë se vendimmarrja e organit të akuzës për mosfillimin e këtij procedimi penal nuk duhet të fokusohet vetëm në anën subjektive të faktorëve që mund të kenë nxitur kallëzuesin në depozitim të kallëzimit, por duhet të reflektojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe objektive, duke promovuar tek publiku rëndësinë e garantimit të procesit të rregullt ligjor.

2.2. Pushimi i akuzës ose çështjes penale

Vetëm në 3 raste rezulton se organi i akuzës ka kërkuar pushimin e akuzës ose çështjes, bazuar në kompetencën dhënë sipas nenit 329/a K.Pr.P. Dy prej këtyre rasteve i korrespondojnë të njëjtës çështje, më konkretisht rastit të kallëzimit penal të një shtetaseje, e cila pretendonte se dy inspektorë të IMT Tiranë i kanë marrë në kushtet e një presioni psikologjik një shumë prej 1000 Euro, për të mos deklaruar për ndërtimin pa leje që shtetasja po realizonte në ambientet e apartamentit të saj. Ndaj kallëzimeve të depozituara ndaj 2 inspektorëve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë kërkoi pushimin e çështjes penale. Fillimisht hetimet paraprake janë ndërmarrë nga SPAK, por ky i fundit ka konstatuar se nuk është vërtetuar rasti i korrupsionit, por duke qenë se në procesverbalin e kontrollit në banesë të mbajtur nga inspektorët

nuk ka nënshkruar pronari i banesës, SPAK ka referuar për kompetencë çështjen pranë Prokurorisë së Rrethit. Pas pretendimit nga ana e inspektorëve se mungesa e nënshkrimit nga ana e pronarit ka ardhur si rrjedhojë e mos prezencës së tij në banesë, Prokuroria ka vendosur pushimin e hetimeve paraprahe. Pas njohjes me rrethanat faktike, ekspertët vlerësojnë se organi i akuzës duhet të mbante parasysh edhe parashikimin e nenit 12 të ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, mbi detyrimin e inspektorëve për të dokumentuar mosprezencën e pronarit në procesverbal, dhe jo duke u mjaftuar thjesht me deklarimin verbal. Por kjo vendimmarrje rezulton të mos jetë ankimuar as nga ana e palës kallëzuese.

2.3. Trendi i masave të sigurimit

2.3.1. Masa e sigurimit personal “arrest në burg”

Në 21 raste ose rreth 5% rezulton që përfaqësuesit e organit të akuzës të kenë kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, por vetëm në 17 nga këto raste rezulton që kërkesa e prokurorit për caktimin e kësaj mase të jetë aprovuar nga ana e Gjykatës. Por kjo masë siguri personal është ruajtur deri në Gjykatën e Apelit vetëm për 12 raste, pasi 5 rastet e tjera janë shoqëruar me zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

Sa i përket rasteve, të akuzuarit e të cilave nuk kanë pësuar ndryshim të masës së sigurimit personal gjatë shqyrtimit të çështjes në dy shkallët e gjyqimit, reflektojnë raste të bujshme për mediat, siç janë 2 inspektorë të IMT Vendore Bashkia Kamëz të cilët janë arrestuar pas denoncimeve të vazhdueshme nga qytetarët, nga të cilët kanë kërkuar dhe përvetësuar shumë të konsiderueshme monetare, në shkëmbim të mos ndëshkimit të tyre për ndërtimet e paligjshme të realizuara. Masat e sigurimit ndaj këtyre dy funksionarëve janë caktuar në mungesë nga ana e SPAK.

2 raste të tjera i korrespondojnë 2 infermiereve të cilat ushtronin funksionin pranë Spitalit Shefqet Ndroqi, ndërkohë që gjatë periudhës së përhapjes së Covid-19 në vendin tonë, u përfshinë në një aferë korruptive,

duke i kërkuar një qytetareje shuma të konsiderueshme monetare për të ofruar shërbimin dhe përmbushur funksionin e tyre ndaj nënës së qytetares. Fillimisht ndaj të akuzuarave është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” me afat 45 ditor, ndërkohë për shkak të vlerësimit të gjendjes shëndetësore u zëvendësua masa e sigurimit me atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Ndërkohë 2 raste të tjera janë regjistruar ndaj 2 punonjësve të Policisë Poliçan, të përfshirë në operacionin e ndërmarrë pas referimit të kallëzimit nga SHÇBA në SPAK, pas administrimit të provave se funksionarë të ndryshëm dhe qytetarë pjesë e një grupi funksional në zonën e Skraparit kanë ndërmarrë disa vepra penale në fushën e drogërave. Punonjësit e policisë së kallëzuar si dhe disa funksionarë publikë pjesë e Njesisë Administrative Tërpan, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë lejuar kultivimin e lëndëve narkotike nën juridiksionin territorial të Njesisë.

38 shtetasë shqiptarë u arrestuan në kuadër të operacionit “Shpirti”, pjesëtarë të katër grupeve të fuqishme kriminale të organizuara, vepruese nga viti 2014 deri në vitin 2017, në Shqipëri dhe në kontakt me organizatat kriminale bareze, në gjendje të dërgonin në Evropë duke zbarkuar në Puglia sasi të konsiderueshme lënde narkotike. Ndërkohë që ndaj pjesës më të madhe të këtyre shtetasve rëndonin akuza penale në fushën e narkotikëve, ndaj njërit prej shtetasve më konkretisht ish-komisar të akuzuar për “shpërdorim detyre” u vendos masa e sigurimit “arrest në burg”.

Rastet e tjera i korrespondojnë operacionit, në kuadër të vendimmarrjes së SPAK u vendosën nën pranga 10 zyrtarë të Bashkisë Lushnjë, përfshirë dhe kreun e kësaj Bashkie. Në përfundim të fazës së hetimeve paraprake u konkludua se zyrtarët kanë shpallur fitues të tenderit për rehabilitimin e një ujësjellësi, një subjekt i cili nuk plotësonte kriteret ligjore. Mjete dhe metoda speciale hetimi të alternuara me ato tradicionale, u përdorën gjatë fazës së hetimeve paraprake. Masat e sigurimit personal “arrest në burg” u caktua nga ana e SPAK ndaj dy shtetasve të akuzuar nën nenin 248 K.P. më konkretisht ndaj Kryetarit

të Bashkisë dhe Drejtorit të Ndërmarrjes së Pasurisë Publike në këtë Bashki.

2.3.1.1. Zëvendësimi i masës së sigurimit “arrest në burg”

Në 4 raste rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, duke caktuar në 1 rast masën e sigurimit “arrest në shtëpi” dhe në 3 rastet e tjera “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Por dhe masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë u ndryshua gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Apelit, duke u zëvendësuar me masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Nga të dhënat e referuara në dosjen gjyqësore, rezulton se zbutja e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit turk u zbatua për shkak se materialet pjesë e dosjes hetimore nuk rezultojnë të jenë nënshkruar nga ana e personit nën hetim. Ky shtetas ishte arrestuar në kuadër të operacionit “Viza” sëbashku me një ekonomist, për shkak se në bashkëpunim kundrejt përfitimeve të shumave prej 1000-1500 Euro i kanë premtuar shtetasve të huaj pajisjen me dokumentacion si viza dhe leje qëndrimi në RSH.

Ndërkohë 3 rastet e tjera i korrespondojnë hetimit të ndërmarrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ndaj kreut të IMT-së Tiranë dhe 2 inspektorëve, të cilët dyshohen se kanë shpërdoruar detyrën duke lejuar ndërtimin e paligjshëm të dy qytetarëve. Policia rezultoi të ketë konstatuar se sipërmarrësit e ndërtimit ishin të pajisur me deklarata paraprake, e cila disponohet vetëm për meremetime të thjeshta, por kërkesat e përfaqësuesve të organit procedues nuk u pranuan nga ana e Gjykatës.

2.3.2. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi”

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 K.Pr.P. është kërkuar nga ana e organit të akuzës në 11 raste. Në 10 raste kjo kërkesë është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit në 9 raste. Ndërkohë vetëm në rastin

e sipërcituar është vërejtur mos aprovimi i kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj të kallëzuarës, dhe caktimi i masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policing gjyqësore” për të.

Sa i përket rasteve të tjera objekt monitorimi, duke qenë se këto raste gjenden të sipër përmendura, ekspertët risjellin në vëmendje se kërkesat e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” u aprovuan nga ana e dy shkallëve të gjykimit për: shefin e stacionit të Policisë Poliçan dhe administratorin e Njesisë Administrative Tërpan, të përfshirë në operacionin e ndërmarrë në Skrapar; ish- zv/drejtorin e Policisë Vlorë dhe prokurorin e Vlorës të përfshirë në operacionin “Shpirti” dhe 4 zyrtarëve të Ndërmarrjes së Pasurisë Publike në Bashkinë Lushnje.

2.3.3.Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Përfaqësuesit e organit procedues për 8 raste të dyshuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kjo kërkesë është aprovuar në të gjitha rastet nga Gjykata e Shkallës së Parë, ndërkohë që vetëm në 1 rast ka përfunduar shqyrtimi në Gjykatën e Apelit duke lënë në fuqi të njëjtën masë sigurimi personal.

Ndër rastet pikante, ekspertët kanë identifikuar rastin e 4 punonjësve të doganës dhe 5 shtetasve, të dyshuar për kryerjen e veprave penale në fushën e kontrabandës së mallrave. Punonjësit e doganës rezulton të kenë favorizuar tregtarët, duke lejuar kalimin e mallrave pa disponuar dokumentacion dogane dhe pa paguar detyrimet doganore. Asnjë prej punonjësve të doganës nuk rezulton që të ketë ankimuar masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Një tjetër rast që tërhoqi vëmendjen e ekspertëve konsistonte në konstatimin e një parcele të mbjellur me lëndë narkotike të llojit cannabis sativa, nga ana e Specialistëve për Hetimin e Krimeve në Komisariatit e Policisë Vorë. Krahas arrestimit në flagrancë të dy

shtetasvë babë e bir, u proceduan në gjendje të lirë Inspektori i Pyjeve dhe Kryeplaku i fshatit. Para OPGJ-ve ky i fundit deklaroi se ka ushtruar kontrolle të vazhdueshme në zonë prej 2 vitesh, por nuk është konstatuar kjo sipërfaqe.

2.3.4.Masa ndaluese “pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”

Kjo masë ndaluese rezulton të jetë kërkuar nga ana e prokurorit vetëm në një rast, njëkohësisht me kërkesën për gjykim të depozituar prej tij në Gjykatë. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në përfundim të hetimeve paraprake ndaj 3 zyrtarëve, pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për abuzim me tenderin e ushqimeve për familjet në nevojë, krahas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj tyre. Pjesë e këtij procedimi penal në cilësinë e të akuzuarit rezultonte dhe drejtori i komanduar i Rezervave të Shtetit. 3 zyrtarët pjesë e Komisionit akuzohen për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera ose ankande publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258 e 25 i Kodit Penal, ndërkohë drejtori i komanduar akuzohet për shpërdorim të detyrës. Gjithashtu, SPAK ka kërkuar caktimin e masës ndaluese “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 K.Pr.P., kërkesë e cila u refuzua nga ana e Gjykatës së Posaçme duke mos caktuar asnjë masë siguri ndaj funksionarit publik. Gjatë monitorimit u konstatua se për këtë dosje me katër shtetas nën hetim rezulton se nga akuza e shkeljes së barazisë në tendera, gjykata e kualifikoi çështjen për shpërdorim detyre dhe më pas shpalli mos kompetencën duke ja kaluar Gjykatës Penale Tiranë. Ekspertët e Qendrës Fol vlerësojnë se praktika të kësaj natyre, të ndjekura ndaj funksionarëve publikë, përveç se reflektojnë një lehtësim jo proporcional dhe të paargumentuar të pozitës penalo-procedurale mund të krijojnë premisa për ndikim në procesin hetimor, ndërkohë që ata vijojnë funksionet e tyre publike në kontakt të vazhdueshëm me provat dhe indiciet objekt hetimi.

3. Krimet Zgjedhore

3.1. Fenomeni i korrupsionit aktiv në zgjedhjet parlamentare Prill 2021

Procesi elektoral i zgjedhjeve parlamentare Prill 2021 tërhoqi jo pak vëmendjen e mediave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare, ndërkohë që vëzhguesit vendorë dhe ata të OSBE/ODIHR ritheksuan domosdoshmërinë për ndërmarrjen e hapave aktivë nga ana e autoriteteve proceduese në luftën ndaj pandëshkueshmërisë së krimeve zgjedhore. Në mars 2020, Këshilli European vendosi të hapë negociatat me Shqipërinë dhe të mbajë Konferencën e parë Ndër-Qeveritare të 27 vendeve anëtare të BE-së me Shqipërinë, ndërkohë që qeveria holandeze rezultoi të ketë kërkuar me ngulm *“se autoritetet shqiptare tani duhet t’i japin substancë të mëtejshme hetimit dhe të ndjekin penalisht komisionerët e zgjedhjeve dhe votuesit e përfshirë. Gjithashtu, çështjet e reja të paraqitura në zgjedhjet e fundit kërkojnë trajtim të shpejtë. Këto raste duhet të parandalohen që të ndalohen me kohë”*.¹⁰ Gjatë procesit zgjedhor, partitë opozitare ngritën vazhdimisht akuza për korrupsion, shpërdorim të burimeve shtetërore dhe për lidhje me krimin e organizuar.¹¹

¹⁰ <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/06/holand-anetaresim-kushte.pdf>
Përkthim i aksesueshëm në artikullin “Holanda për konferencën Shqipëri-BE: Kushtet të plotësohen, krimet zgjedhore të ndëshkohen”, publikuar nga Infoçip. Link: <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/06/04/holanda-per-konferencen-shqiperi-be-kushtet-ge-duhen-plotesuar-krimet-zgjedhore-duhen-ndeshkuar/>

¹¹ Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, fq. 17, fotnote 69, publikuar më 26 Korrik 2021. Link: <https://ëëë.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>


Deri në muajin Shtator 2021, sipas të dhënave zyrtare të bëra publike nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) rezulton se 149 materiale janë regjistruar, ku pjesa më e madhe e materialeve rezulton të jenë referuar nga ana e subjekteve politike, përkatësisht 89 raste ose rreth 60% e tyre.



Rastet e monitoruara nga ana e ekspertëve të Qendrës “Fol”, rezultojnë të analizuar vetëm sa i përket veprave penale të parashikuara në nenet 328 K.P. “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe 328/a K.P. “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” Prill dhe Maj 2021.

Materialet e regjistruara në muajin Maj 2021, i përkojnë vetëm veprës penale të parashikuar nga neni 328/a K.P. “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.


3.2. Subjektet proaktive depozitues të kallëzimeve penale



Siç konstatohet nga të dhënat forcat opozitare kanë luajtur një rol proaktiv, duke i besuar referimin e të gjitha indicieve për raste konkrete strukturave të posaçme të ngritura në kuadër të reformës në drejtësi. Subjektet elektorale nuk rezultojnë të jenë të vetmet që kanë referuar çështje pranë kësaj strukture, pasi rol proaktiv rezulton të kenë luajtur dhe Drejtoritë Vendore të Policive,


institucioni i Presidentit, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Sistemit të Burgjeve, Oficerët e Policive

Gjyqësore, shtetasit dhe kryesisht vetë SPAK. Nisur nga këto të dhëna të subjekteve referues konstatohet se përveç rritjes së besimit të shtetasve tek SPAK, duhet vlerësuar dhe impakti pozitiv i sensibilizimit të shtetasve mbi krimin zgjedhor dhe pasojat negative që shkakton ky fenomen në objektivitetin e procesit elektorale dhe në jetën politike të vendit.



3.3. Shpallja e moskompetencës nga SPAK dhe mosfillimi i procedimeve penale


Jo në të gjitha rastet e sipërcituara ka rezultuar që SPAK të jetë kompetent, duke bërë që fati i procedimeve penale të përcaktohet nga ana e organeve proceduese të juridiksionit të përgjithshëm, siç janë Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.



Nga 149 materialet e referuara pranë SPAK, në 60 raste ose rreth 40% e rasteve, Prokuroria ka regjistruar procedimin penal, ndërkohë që në 20 raste (ose rreth 13%) organi procedues ka vendosur bazuar në nenet 290 e vijues K.Pr.P. mosfillimin e procedimit penal. Për shkak të sekretit hetimor dhe sensitivitetit të këtyre çështjeve, vetëm disa çështje

pikante dhe që përbëjnë interes për publikun kanë mundur të analizohen në mënyrë të detajuar, ndërkohë që për çështjet e tjera mbeten të paqarta arsyet që kanë shtyrë SPAK për të vendosur mosfillimin e procedimeve penale. Gjithashtu, mbetet e paqartë nëse subjektet referues, qofshin ato subjekte politike, institucione publike apo shtetas të kenë ndërmarrë hapat proceduralë për ankimin e këtyre vendimmarrjeve në Gjykatë, në përputhje me nenin 291 pika 2 K.Pr.P.


Procedimet e regjistruara nga ana e SPAK rezultojnë të jenë në pjesën më të madhe në fazën e hetimeve paraprake, përkatësisht 36 raste ose rreth 58%. Ndërkohë që kërkesë për pushim është depozituar nga ana e prokurorit të çështjes vetëm në 1 rast. 4 procedime penale rezultojnë të jenë bashkuar me procedime të tjera të lidhura, bazuar në nenet 79 e vijues të K.Pr.P.



Ekspertët kanë mundur që të monitorojnë vetëm 19 procedimet e transferuara nga ana e SPAK pranë Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ku numrin më të lartë të transferimeve e konstatojmë drejt Prokurorisë Fier dhe Prokurorisë Lushnjë. Nëpërmjet këtyre të dhënave, në analizë krahasimore ndërmjet dy diagramëve të sipërcituar, ekspertët vlerësojnë se duhet mbajtur në konsideratë se shifra prej 50 rasteve përkon me numrin e kallëzimeve dhe procedimeve penale të transferuara për kompetencë, ndërkohë që vetëm 19 prej tyre kanë rezultuar të regjistruara si procedime penale. Vijueshmëria e regjistrimit ose vendimmarrja mbi pjesën e mbetur prej 31 materiale/kallëzime pas shpalljes së moskompetencës dhe transferimit nga SPAK është kompetencë e Prokurorive pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor. Për shkak të mungesës së ëëbsite/faqe zyrtare të këtyre Prokurorive gjatë regjistrimit të këtyre procedimeve penale mbetet e paqartë vendimmarrja e tyre mbi to, ndërkohë që Prokuroria e Përgjithshme vetëm në muajt e fundit vërehet se ka marrë masa konkrete në funksion të hartëzimit të ëëbsite edhe për Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, por në seksionet respektive të tyre ende vijnë të konstatohet mungesa mbi fatin e këtyre procedimeve penale.

3.4. Analiza e fashikujve hetimorë dhe gjyqësorë të disa prej çështjeve “pikante”

Nga analiza e realizuar nga ana e ekspertëve fashikujve respektivë, rezulton se në 5 raste të cilësuar si “pikante” forca opozitare PD i është drejtuar SPAK pasi ka disponuar indicie se fenomeni i shitblerjes së votës është përkrahur dhe kryer nga shtetas të caktuar. Në 1 rast, SPAK rezulton të ketë regjistruar procedimin penal pa emër, në qarkun e Durrësit, duke specifikuar se subjekte të përfshira rezultojnë zyrtarë dhe persona që kanë dhënë ndihmën e tyre në kryerjen e veprimeve korruptive në fushën e zgjedhjeve dhe veprave të tjera që lidhen me to. Ndërkohë në 2 raste të tjera, subjekti politik ka referuar të dhëna konkrete rreth shtetasve konkretë, të cilët dyshohen se në bashkëpunim me zyrtarë publikë dhe deputetë kanë ndikuar në procesin zgjedhor Prill 2021. Në 2 materiale të referuara nga ana e subjektit politik opozitar,



SPAK ka shpallur moskompetencën juridiksionale duke i përcjellë për kompetencë pranë Prokurorisë së juridiksionit të zakonshëm Tiranë, ndërkohë që subjektet e kallëzuara rezultojnë punonjës të një subjekti tregtar privat. Projekt-menaxheri i subjektit

është kallëzuar si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 329 KP “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, 331/a KP “Marrja ose përdorimi paligjshëm i dokumentave të identifikimit” dhe 328 KP “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”. Në të dyja këto raste Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë vendosi mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që nuk rezulton se subjekti politik referues të ketë ankimuar këtë vendimarrje pranë instancave gjyqësore.

Krimi zgjedhor në këto zgjedhje parlamentare duket se nuk ka njohur ndasi territoriale, pasi është shtrirë në disa qarqe të vendit si Durrës,

Tiranë, Vlorë, Dibër etj. Media gjithashtu ka shërbyer si një mjet për informimin e publikut, por edhe sjelljen në vëmendje të organeve proceduese të rasteve flagrante që ndodhin. Specialistët e Seksionit për Hetimin e Korrupsionit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, pas transmetimit në median audio-vizive të rastit korruptiv, ndaluan një qytetar dhe shpallën në kërkim kandidatin për deputet të një subjekti politik në qarkun Tiranë. Përfaqësuesi i organit procedues kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, kërkesë e cila u aprovua edhe nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Vetëm disa ditë më parë u bë i mundur ekzekutimi i kësaj mase sigurimi, për shkak se personi nën hetim rezultonte në kërkim nga ana e forcave të policisë. Edhe në rastin e konstatuar në Dibër, u ekzekutua arrestimi në flagrancë i dy shtetasve, në automjetin e të cilëve 3 ditë përpara ditës së zgjedhjeve iu sekuestrua një shumë e konsiderueshme monetare, modele për të orientuar zgjedhësit për mënyrën e votimit si dhe fletëpalosje të një subjekti politik. Njëri prej këtyre shtetasve, funksionar pranë një institucioni publik¹² dyshohej se ka përdorur funksionin e tij për veprimtari politike, për këtë shkak ky procedim penal u kategorizua nën nenet 328 dhe 25 KP “Korrupsion aktiv në zgjedhje kryer në bashkëpunim” dhe 328/a KP “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Prokuroria kërkoi ndaj këtyre dy shtetasve caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, masë e cila fillimisht u vlerësua dhe u la në fuqi nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në përputhje me nenin 28 K.Pr.P., Gjykata e Posaçme ka vlerësuar sërish masën e sigurimit personal, duke lënë në fuqi të njëjtën vendimmarrje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, pra duke caktuar ndaj shtetasve masën e sigurimit “arrest në burg”, fakt i cili provon se kushtet dhe kriteret e zbatimit të saj nuk kanë ndryshuar nga momenti i kërkesës së parë të depozituar nga ana e organit procedues. Më dt. 18.10.2021, Prokuroria e Posaçme ka përfunduar hetimet paraprake dhe ka dërguar në Gjykatën e Posaçme kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurve të sipërcituar.

¹² Përgjegjës i zyrës juridike në Bashkinë Bulqizë.

Ekspertët kanë konstatuar se përfaqësuesit e organeve proceduese pranë Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë nuk kanë ndjekur një qasje të unifikuar, edhe përpara rrethanave faktike të ngjashme, duke kërkuar masa të ndryshme sigurimi për shtetasit nga rasti në rast. Përkatësisht në ngjarjen e regjistruar në Durrës, specialistët për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës kanë arrestuar në flagrancë 2 shtetas, përfaqësues të një subjekti politik. Gjatë kontrollit kryer në automjetin me të cilin këto shtetas po udhëtonin në vendin e quajtur “Bishti i Kamzës” u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 28 zarfë me nga 5 dhe 10 mijë lekë secili, që dyshohen se do të përdoreshin për blerjen e votës, si dhe fletë votimi të cikluara për një subjekt politik. Ndaj këtyre shtetasve, prokurori i caktuar kërkoi caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, sipas nenit 234 K.Pr.P. Kjo kërkesë u aprovua nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës e cila përcaktoi paraqitjen pranë zyrës së policisë gjyqësore çdo të hënë të parë dhe të tretë të çdo muaji.

Në analizë krahasimore ndërmjet tre rasteve të sipërcituara të ndodhura në Tiranë, Dibër dhe Durrës, vërehet qasja e ndryshme e përfaqësuesve të Prokurorisë ndaj kërkesave për caktimin e masave të sigurimit. Bazuar në rrethanat faktike të këtyre çështjeve, konstatohet se gjatë arrestimit në flagrancë të autorëve të dyshuar në automjetet me të cilat udhëtonin janë gjetur materiale të cilat mund të kenë pasur si qëllim të ndikojnë në vullnetin e zgjedhësve, rrjedhimisht ana subjektive dhe ajo objektive e kryerjes së veprave penale ka qenë pothuajse e njëjta, por në vlerësimin e organeve proceduese rezulton se këto raste janë pasqyruar në mënyra të ndryshme, në formë jo të argumentuar dhe në mungesë unifikimi të praktikave të ngjashme.

3.4.1.Sa kushton një akt korruptiv?

Ekspertët e Qendrës “FOL” i kanë kushtuar vëmendje të shtuar studimit dhe analizës së të dhënave të prodhuara nga procedimet penale dhe vendimmarrjet e pushtetit gjyqësor, në luftën ndaj korrupsionit. Nisur

nga këto të dhëna konstatojmë se ky fenomen mbetet një fenomen në rritje të vazhdueshme, i cili bashkëshoqëron zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik të shoqërisë shqiptare. Bie në sy fakti se qytetarët janë promovuesit fillestarë të mekanizmit të korrupsionit vertikal, pasi e zgjedhin si formën më të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë për të arritur qëllimin e tyre, qoftë ai dhe i paligjshëm.

“Të shpërblesh paligjshmërinë me shifra të vogla monetare” ky është fenomeni risi me të cilin po përballet shoqëria shqiptare, por fatmirësisht konstatohet një mobilizim dhe rritje e përgjegjshmërisë së përfaqësuesve të autoriteteve ligjzbatuese për të ndëshkuar autorët e dyshuar.

Nga rreth 578 rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë periudhës 1 vjeçare, qytetarët zgjedhin të paguajnë vlera monetare duke filluar nga 10 euro ose 1000 lekë (të reja) për të përfituar nga paligjshmëria. Në rastet e konstatuara vërehet se punonjësit e veshur me tagra shtetërore, qofshin ata punonjës të Policisë së Shtetit apo punonjës të Pikave të Kalimit Kufitar kanë reaguar në mënyrë aktive duke kallëzuar qytetarët pranë organeve proceduese, me qëllim vënien e tyre para përgjegjësisë. Një praktikë e tillë vlerësohet si pozitive, duke mbajtur parasysht qëllimin dhe objektivin që synohet të arrihet për të reduktuar korrupsionin.

Qëllimi për shmangien e ndëshkimit me masa administrative në rastet e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor është një tjetër arsye “e fortë” e cila i ka shtyrë qytetarët që të ofrojnë të vlera monetare në adresë të punonjësve të Policisë së Shtetit. Në një rast, qytetari është ndaluar nga ana e efektivëve të policisë për shkak se ka qenë duke drejtuar mjetin në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, më konkretisht në drejtim të mjetit në gjendje të dehur. Ai ka tentuar t’i japë 1000 lekë të reja policit, ndërkohë që prej këtij të fundit i është bërë me dije se pasi qytetari t’i nënshtrohej testit të dytë me drager ndaj tij do të vendosej masë administrative. Në ato momente, qytetari ka dalë nga mjeti dhe ka hedhur në automjetin e policisë kartmonedhën, duke iu drejtuar me fjalët “Na merrini këto dhe pini ujë, e mos rrini t’i vendosni gjobë njerëzve këtu”. Pas paralajmërimit nga efektiv i policisë është ekzekutuar arrestimi në flagrancë i qytetarit, ndërkohë që prokurori ka kërkuar

masën e “detyrimit për t’u paraqitur pranë policisë gjyqësore” e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës.

Edhe në deklaratimet e dhëna nga ana e qytetarit është pranuar veprimi i kryer me pretendimin se qëllimi ka qenë që efektivet “t’i qeraste me disa pije freskuese”. Në raste të tilla, kur autori i dyshuar është në gjendje të dehur, fakt lehtësisht i provueshëm nga të dhënat e testit të realizuar, ekspertët sugjerojnë se politika penale duhet të ketë ndikim parandalues të veprave me pasoja më të rënda në shëndetin apo jetën e personave. Në raste të ngjashme, do ishte e rekomandueshme që personi nën hetim t’i nënshtrohej masës alternative të dënimit sipas nenit 59 K.Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, ndërkohë që gjykata të detyronte shtetasin që të mos drejtonte automjete të caktuara brenda periudhës së provës.

Mungesa e vendosjes së rripit të sigurimit, si një nga format e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor mund të sjellë pasoja jo vetëm për drejtuesin e mjetit dhe udhëtarët, por edhe për kalimtarët. Sipas ndryshimeve të majit 2021, në nenin 170 të Kodit Rrugor parashikohet përgjegjësia administrative me gjobë për drejtuesin e mjetit edhe në rast se pasagjerët nuk respektojnë rregullat e fiksimit apo vendosjen e rripit të sigurimit. Në 8 raste qytetarët janë ndaluar nga ana e efektiveve të policisë për shkak se nuk kanë vendosur rripin e sigurimit. Për shmangien nga masa administrative kanë tentuar të korruptojnë policët me vlera monetare nga 1000 – 2000 lekë të reja, veprim i cili është pasuar me arrestimin në flagrancë të tyre.

Nisur nga rrethanat faktike të analizuara, ekspertët konstatojnë se zbatuesit e ligjit në përgjithësi kanë mbajtur një qëndrim konform legjislacionit në fuqi, duke nxitur një politikë penale fleksibël dhe duke shmangur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” si një reagim i drejtpërdrejtë në luftën ndaj korrupsionit. Nisur nga rastet në rritje në ditët e fundit, fenomeni i korrupsionit i cili prek të gjitha sferat dhe fushat e jetës po “ushqehet” edhe me vlera të ulëta monetare.

Proaktivizmi i efektiveve të Policisë mbetet për t’u vlerësuar, ndërkohë që ekspertët janë të qëndrimit se një qasje e tillë duhet të shtrihet me qëllim sensibilizimin e përfaqësuesve shtetërorë në të gjithë sektorët e

administratës publike, me synim për t'i thënë “JO KORRUPSIONIT” si zgjidhja më e mirë e mundshme në favor të emancipimit të interesit publik.

4. Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike apo zgjedhore

Me një vendim unanim, më 24 dhjetor,¹³ Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendosi të kufizojë disa veprimtari të subjekteve apo zyrtarëve politikanë, kryesisht me karakter promovimin e “punëve të mira”, në një periudhë 4-mujore para ditës së zhvillimit të zgjedhjeve (25 prill 2021) e deri në caktimin e qeverisë së re. Në përputhje me nenin 10 të kësaj vendimmarrje, kur shkelja nuk përbënte vepër penale dënohej administrativisht nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me masë administrative gjorbë. Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, deri më datë 21 Shtator 2021, ky institucion ka vijuar me rishqyrtimin e administrativ të denoncimeve të përcjella nga përfaqësues të shoqërisë civile.¹⁴ KQZ ende nuk ka bërë publik një raport të detajuar mbi numrin e denoncimeve nga publiku dhe faktin nëse KQZ ka ndërmarrë procedurën e referimit të këtyre rasteve në Prokurori, por nga të dhënat e bëra zyrtare nga organizma të pavarur monitorues vendor rezulton se deri në muajin Gusht 2021, në portalin e denoncimeve të administruar pranë KQZ-së janë regjistruar 135 sinjalizime/denoncime të qytetarëve. Sipas të dhënave që KQZ i ka përcjellë aktorit vendas monitorues, asnjë rast nuk është referuar për ndjekje penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme apo SPAK.¹⁵

Nisur nga 13 rastet e monitoruara nga ana e ekspertëve, rezulton se subjektet referues të ngjarjeve të kategorizuara nën fushë-veprimin e

¹³ Vendim nr. 9, dt. 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publikë të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimi i veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Link: http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2020/12/Vendimi_9_201224_P%D1%91r-rregullat-e-raportimit-te-veprimtarive-me-karakter-publik-te%CC%88-cdo-institucioni-publik.pdf

¹⁴ Link: <http://kqz.gov.al/2021/09/17/plotesohen-vakancat-ne-7-keshilla-bashkiak-vijon-hetimi-administrativ-per-denoncimet-e-veprimtarive-te-ndaluara-gjate-fushates-zgjedhore/>

¹⁵ <https://ëëë.krimizgjedhor.com/index.php/2021/08/16/kqz-administroi-135-sinjalizime-denoncime-per-parregullsi-ne-zgjedhjet-e-25-prillit-asnje-nuk-u-referua-ne-prokurori/>

nenit 328/a K.P. janë Policia, shtetas, institucioni i Presidentit, Prokuroria e Posaçme SPAK dhe subjekti politik opozitar PD.



Më konkretisht në 4 prej këtyre rasteve ose rreth 31%, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që për rastet e tjera vijnë ende ndërmarrja e hetimeve. 3 prej këtyre rasteve janë referuar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nga ana e institucionit të Presidentit. Në një rast materiali kallëzues referohet ndaj një funksionari të lartë të Autoritetit të Konkurrencës dhe ndaj një Ministri, ndërkohë që Presidencia që ka depozituar kallëzimin ka pretenduar se këta

shtetas kanë përdorur funksionin e tyre publik për qëllime politike dhe zgjedhore gjatë fushatës parazgjedhore, mbetet e paqartë përse nga ana e institucionit kallëzues nuk është vijuar ndërmarrja e procedurave për ankimin e vendimmarrjes së mosfillimit të çështjes. Ekspertët e shohin me shqetësim mungesën e proaktivizmit për ndërmarrjen e të gjitha hapave proceduralë në rastet e mosfillimit të procedimeve penale, për shkak se kjo mungesë “përqafohet” nga ana e institucioneve publike të cilat kanë kapacitetet dhe burimet e nevojshme njerëzore për t’ja besuar vendimmarrje të kësaj natyre pushtetit gjyqësor. Ekspertët besojnë se rikthimi i besimit të qytetarëve tek drejtësia duhet të vijë nga forcimi i besimit që vetë autoritetet publike kanë tek sistemi i drejtësisë! Lidhur me çështjen e sipërcituar, vlen të sjellim në vëmendje se edhe SPAK ka referuar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë zyrtarët e lartëpërmendur të nivelit të lartë, pasi për shkak të veprës penale që i atribuohet të kallëzuarit SPAK ka shpallur moskompetencën.

Vetëm në 2 raste, Policia rezulton të ketë referuar në gjendje të lirë 2 shtetas, të cilët janë konstatuar duke fotografuar votën në ditën e

votimit, ndërkohë që në njërën prej rasteve organi procedues ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Fenomeni i fotografimit të votës ishte shqetësues në Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021.¹⁶ Ekspertët vlerësojnë se duke mbajtur parasysh domosdoshmërinë e implementimit të një politike penale humaniste, në favor të caktimit të masës së sigurimit shtrënguese “arrest në burg” si një masë e fundit e aplikueshme, qasja e cila duhet të përdoret nga ana e përfaqësuesve të organeve proceduese duhet të priret drejt proporcionalitetit në raport me qëllimin që synohet të arrihet. Në rastin e fotografimit të votës, pas ndryshimeve të vitit 2017 në legjislacionin penal material, është parashikuar si vepër penale ndërmarrja e këtij veprimi nën lëmin e nenit 327 K.P. Kjo dispozitë e cila e ka parashikuar këtë vepër penale në formën e krimit, vlerësojmë se duhet të zbatohet dhe jo të mbahen qasje të ndryshme për të njëjtin veprim nga përfaqësues të ndryshëm të organeve proceduese, pasi nëpërmjet zbatimit të kësaj dispozite në përputhje me qëllimin që ligjvënësi ka pasur synohet në mënyrë direkte shmangia e pandëshkueshmërisë përballë këtij fenomeni i cili impakton kulturën shqiptare.


SPAK rezulton të ketë shpallur moskompetencën lëndore dhe të ketë referuar çështjet pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në 5 raste ose rreth 38.5%, për shkak të akuzës së ngritur, pavarësisht se funksionarët e kallëzuar rezultojnë drejtues të lartë të institucioneve publike në nivel qendror, siç është kallëzimi ndaj Ministres së Infrastrukturës, ndaj zyrtarëve të Akademisë së Sigurisë, ndaj ish deputetëve dhe ish ministrave etj. Qëndrimin për shpalljen e moskompetencës, SPAK e ka përkrahur edhe në çështjen e përdorimit të të dhënave personale të qytetarëve nga ana e “patronazhistëve”¹⁷. ODIHR në Raportin e përpiluar gjatë misionit të kufizuar monitorues e trajtoi në veçanti këtë çështje, e cila krijonte premisa që të konsiderohej ‘shkelje e angazhimit për mbrojtjen e të drejtës për jetën private dhe

¹⁶ Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) si një ndërkombëtare organizatë e njohura në vend mbi monitorimin e procesit zgjedhor ka konstatuar se: “Pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, KShH u sinjalizua për tentativa të fotografimit të votës²⁷ apo përdorimit të telefonit²⁸ në disa prej QV-ve, në 14 Bashkitë objekt monitorimi”. Link: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/06/Raport-Monitorimi_-Zgjedhje-Parlamentare-ne-14-Bashki-te-vendit.pdf

¹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=eVHf9w9DE5c>

familjare'.¹⁸ Pas 7 muajve hetime, SPAK vendosi se rrethanat faktike të konstatuara nuk përbënin elementë të figurave të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, por e kualifikoi veprën penale si “ndërhyrja në të dhënat kompjuterike” parashikuar në nenin 293/b K.P. Referuar kësaj vendimmarrje, ekspertët janë të qëndrimit se deri në momentin e disponimit me anë të një vendimi penal të formës së prerë nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, palët e interesuara janë të detyruar që të mos e paragjykojnë këtë vendimmarrje, ndërkohë që diskutime dhe debate konstruktive mes palëve si akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile etj., vlerësohet që të realizohen lidhur me krimin kibernetik, sfidat që mund të hasen në hetimin e kësaj çështjeje mbi identifikimin e lokacionit të përdorur nga autori, pasojat e sjella etj.

5. Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën



Funksionarët publikë apo shtetas të ndryshëm, të cilët janë ngarkuar me administrimin ose ruajtjen e pasurisë së caktuar, në 30 raste kanë zgjedhur që të përfitojnë nga pozicioni i tyre dhe ta përvetësojnë pasurinë në mënyrë të padrejtë. Ekspertët kanë monitoruar se në 5 raste ose rreth 17% është ekzekutuar arrestimi në flagrancë i tyre, ndërkohë në mazhorancë pra

83% ose 25 rastet e tjera Policia ka zgjedhur që të procedojë në gjendje të lirë autorët e dyshuar.

Pjesa më e madhe e shtetasve të dyshuar rezulton se janë akuzuar nga ana e administratorëve të kompanive pranë të cilave punojnë, se kanë

¹⁸ Fq. 19. Link: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

vjedhur shuma të konsiderueshme monetare ndërkohë që kanë ushtruar funksionin e tyre.

Në 6 raste organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë në 1 rast është kërkuar pranë gjyqtarit të seancës paraprake pushimi i çështjes. Shtetasit që kanë depozituar kallëzimin në asnjë rast nuk rezultojnë ta kenë ndjekur më tej çështjen, dhe të kenë ankimuar në Gjykatë këto vendimmarrje.

Sa i përket masave të sigurimit personal të kërkuara nga ana e përfaqësuesve të organit të akuzës rezultojnë se në 4 raste ose rreth 13% është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë në të gjitha rastet, por gjatë gjyqimit në shkallën e dytë rezultojnë se pozita procedurale e personave nën hetim është lehtësuar dhe si rrjedhojë masa e sigurimit është zbutur në 2 raste në atë të “arrestit në shtëpi” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Gjithashtu, masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e kërkuar nga ana e organit të akuzës dhe e aprovuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, në rastin e dy shtetasve që kanë vjedhur baterinë në centralin e një kompanie internet, u zëvendësua me atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Apelit. Arsyja e këtij zëvendësimi lidhet me rikualifikimin e veprës penale nën nenin 134/2 K.P. që konsiston në kryerjen e veprës penale nën rrethana cilësuese.

Ndër disa prej rasteve më pikante, ekspertët kanë identifikuar rastin e infermieres e cila u denoncua nga ana e qytetares për shkak se dyshohet se vodhi paratë e një pacienti me Covid-19. Masa e sigurimit “arrest në burg” e lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë ndryshoi në Gjykatën e Apelit në atë “arrest në shtëpi”, për shkak të kërkesës së depozituar nga vetë prokurorja e çështjes për shkak se e pandehura është nënë e dy fëmijëve të mitur.

Roja i caktuar për administrimin e një biznesi në Fushë-Mëzes është shndërruar në autor të dyshuar, në rolin e ndihmësit si pasojë e mosmarrjes së masave për parandalimin apo njoftimin e forcave të rendit

në momentin e ndodhjes së ngjarjes. Pikërisht për mosveprimet e tij, Policia dhe Prokuroria e kanë ngarkuar me përgjegjësi penale, duke e vënë nën masë arresti. Megjithatë vetë i dyshuari gjatë dëshmisë ka hequr përgjegjësinë nga vetja, ndërsa avokati i tij, në seancën për masë sigurimi, kërkoi zbutje të masës, duke argumentuar se e gjithë hapsira e biznesit është 5 mijë metra katror dhe nuk mund të ruhet nga një roje. Por pavarësisht këtyre argumenteve, Gjykata vlerësoi të lërë në burg rojen, i cili do vazhdoj të hetohet për dyshimet se duke shpërdoruar detyrën ka ndihmuar që grabitja të realizohet.

6. Korrupsioni nga ish-përfaqësues dhe përfaqësues të sistemit të drejtësisë

11 raste ose rreth 2% e numrit total të rasteve të monitoruara në kategorinë e korrupsionit, janë monitoruar nga ana e ekspertëve të Qendrës, nën nenet 319/a, 319/ç dhe 319 K.P.

Vlen të vlerësohet se në asnjë prej këtyre rasteve organi i akuzës nuk ka vendosur mosfillimin apo të ketë kërkuar pushimin e procedimit penal, fakt i cili reflekton vendosmërinë e SPAK për të zbardhur ngjarjen dhe për të vënë para përgjegjësisë çdo shtetas, qofshin ata edhe funksionarë të rëndësishëm të sistemit gjyqësor.

Në 5 raste, që i korrespondojnë operacionit të ndërmarrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në të cilin në pranga ranë përfaqësues të mekanizmit të sistemit të drejtësisë, si gjyqtarë, avokat dhe ekspert mjeko-ligjor, Prokuroria krahas kërkesës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ka kërkuar gjykimin e çështjes në themel, për shkak se janë grumbulluar provat e nevojshme të cilat reflektojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen e veprave penale nga ana e personave nën hetim.

Masa e sigurimit “arrest në burg” dhënë ndaj gjyqtarës, avokatit, sekretarës së Gjykatës dhe ekspertit është lënë në fuqi nga të dyja shkallët e gjykimit. Pavarësisht pretendimeve të ish-përfaqësueses së sistemit të drejtësisë, të lidhura me shkaqe familjare dhe shëndetësore, kërkesat e depozituara prej saj për ndryshimin e masës së sigurimit nuk janë pranuar nga ana e Gjykatës, bazuar në rrezikshmërinë shoqërore të

veprës penale për të cilën dyshohet se ka kryer dhe mundësinë e implikimit në prishjen dhe cënimin e provave. Masa e sigurimit “arrest në burg” është caktuar dhe lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Apelit ndaj familjarit të të burgosurit, i cili dyshohej se kishte dhënë 6000 Euro gjyqtarës së përfshirë në skemën e korrupsionit, në mënyrë që i burgosuri të përfitonte ulje dënimi. Por tjetër praktikë u ndoq nga ana e Prokurorisë për mjekun kirurg të përfshirë në përgjimet telefonike, ndaj të cilit për shkak të mungesës së rrezikshmërisë shoqërore nuk u ekzekutua masa e arrestit. Gjatë kontrollit të ushtruar nga SPAK në zyrën e tij u gjendën një shumë e konsiderueshme parash, por masa e sigurimit “arrest në burg” e caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë u ndryshua nga shkalla e dytë në atë të masës ndaluese “pezullim i ushtrimit të detyrës a shërbimit publik”. Për këtë çështje SPAK ka dorëzuar rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar arrest në burg.

Rreth 4 raste të tjera të monitoruara i korrespondojnë të njëjtës dosje, asaj në të cilën rezulton i përfshirë ish-drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Nga SPAK dyshohet se ai ka kërkuar dhe ka përfituar në mënyrë të paligjshme shuma monetare, me synim favorizimin e disa qytetarëve nën hetim nga ana e organit të akuzës të cilin ai drejtonte. Arrestimi i përfaqësuesit të drejtësisë është realizuar pas disa metodave hetimore të vëna në zbatim, të cilat kanë prodhuar prova bindëse mbi përfshirjen e tij me synim ndryshimin e masës së sigurimit ndaj shtetasve të akuzuar për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike.

Krahas kallëzimeve të depozituara për ish-përfaqësues apo përfaqësues aktualë të sistemit të drejtësisë, konstatohet se në 10 raste të tjera qytetarët kanë depozituar kallëzime penale ndaj ekspertëve, qofshin ata topografë apo përfaqësues të OSHEE. Këta shtetas rezultojnë të jenë kallëzuar si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, por në 7 raste organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që 3 rastet e tjera vijojnë ende të jenë në fazën e hetimeve paraprake. Përgjatë nga rastet objekt monitorimi përbën vetëm procedimi penal ndaj ekspertit mjeko-ligjor, të arrestuar në kuadër të operacionit në Gjykatën e Krujës, i cili dyshohet se ka kryer

veprën penale të “ekspertimit të rremë” duke favorizuar lirimin e dy shtetasve. Për shkak të probleme shëndetësore, masa e sigurimit “arrest në burg” është ndryshuar nga ana e Gjykatës së Posaçme në atë të “arrestit në shtëpi”.

7. Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, ose i funksionarëve të lartë shtetërorë apo të zgjedhurve vendorë dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj tyre

Ekspertët kanë monitoruar 26 raste ose rreth 4.5% të numrit total të rasteve të përfshira në kategori. Të gjitha këto raste rezulton të jenë hetuar nga SPAK, por në 3 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal. 2 prej këtyre rasteve lidhen me kallëzimin e depozituar nga ana e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit e cila shigjetonte nëpërmjet kallëzimit të saj funksionarë të lartë të qeverisjes qendrore dhe asa vendore. Ndërkohë rasti tjetër i korrespondon kallëzimit të depozituar nga një shtetas ndaj nënpunësve të ASHK Rurale 2 dhe IMT, rast i cili është transferuar për kompetencë pranë Prokurorisë Tiranë.



Sa i përket masave të sigurimit ekspertët kanë konstatuar se në 12 raste është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, e cila është lënë në fuqi në të gjitha rastet nga të dy shkallët e gjykimit.

Krahas rasteve të

sipërcituar të përfshirë në operacionin e ndërmarrë pranë Gjykatës së Krujës, ekspertët kanë përzgjedhur dhe 3 raste që lidhen me operacionin “Ndërmjetësi”. Në kuadër të këtij operacioni u vunë në pranga disa shtetas dhe funksionarë publikë të Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale 2. Gjithashtu, një tjetër rast interesant i korrespondon ekzekutimit të arrestimit në flagrancë nga ana e punonjësve të Policisë, të dy qytetarëve nën hetim periodik nga SPAK. Punonjësi i Këshillit të Qarkut Dibër kundrejt përvetësimit të një shume parash premtan se do

të ndikojë në mënyrë të paligjshme pranë Zyrës Arsimore Rajonale për të punësuar si mësues qytetarin.

Në 4 raste Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme në të dyja shkallët e gjykimit. Të 4 rastet i korrespondojnë shtetaseve të gjinisë femërore, element i cili në vlerësimin e ekspertëve është ndikues në vendimmarrjen e Gjykatës, nisur dhe nga rrethanat familjare që bashkë-shoqërojnë këto raste. Një prej rasteve pikante lidhet me operacionin e ndërmarrë, në kuadër të të cilit u arrestua edhe zv/Ministrja e Brendshme. Nga dosja hetimore e administruar nga SPAK rezulton se zyrtarja e nivelit të lartë dyshohet se ka përfutur në mënyrë të paligjshme shuma monetare dhe të mira materiale për të punësuar një shtetase në administratë, e konkretisht në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive. Gjykata e Posaçme caktoi ndaj saj masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, masë e cila u la në fuqi në të dyja shkallët e gjykimit. Ndërkohë avokatët mbrojtës të saj pretendojnë se masa e sigurimit e vendosur nuk është proporcionale dhe ajo duhet zbutur, për shkak se nuk ka rrezik ikjeje apo prishje provash dhe as kushte ligjore për të vendosur masë siguri ndaj saj.

2 infermiere rezultojnë subjektet e vetme, ndaj të cilave organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ose masën ndaluese “pezullimi i ushtrimit të detyrës apo funksionit publik”. Këto shtetase sëbashku me një mjek rezultojnë të përfshira në operacionin në kuadër të të cilit u arrestua gjyqtarja e Gjykatës së Krujës. Dyshohet se infermieret janë përfshirë në aktin korruptiv të ndërmarrë nga ana e sekretares së Gjykatës, për t’ja nënshtruar nënën e saj një ndërhyrje kirurgjikale. Ndërkohë dhe masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” e kërkuar nga ana e prokurorit nuk u aprovua nga ana e Gjykatës së Posaçme shkalla e I-rë duke vendosur ndaj infermieres masën ndaluese të “pezullimit të ushtrimit të detyrës apo funksionit publik”.

Interes sa i përket 3 të dyshuarve për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 244 K.P., reflektohen rastet e marrëveshjeve të fajësisë së nënshkruara ndërmjet të akuzuarve dhe përfaqësuesve të

organit të akuzës. 2 prej këtyre rasteve kanë tentuar që të përfshijnë në korrupsion kontrollorë doganorë ose punonjës të pikave të kalimit kufitar. Shumat monetare të ofruara nga të dyshuarit rezultojnë nga 50-100 Euro. Ndaj të 3 rasteve, përfaqësuesi i organit të akuzës depozitoi në Gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes, për shkak se indiciet dhe provat ishin të pakontestueshme, ndërkohë që kërkesat e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është aprovuar nga Gjykata për këto raste. Të 3 çështjet janë hetuar dhe gjykuar pranë Prokurorisë SPAK dhe Gjykatës së Posaçme, ndërkohë që marrëveshja e fajësisë e vënë në zbatim solli ndaj 2 shtetasve përfitimin e konvertimit të dënimit 7 muaj burgim, në 120 orë pune në interes publik. Ndërkohë në rastin e shtetasit tjetër i cili i ofroi policëve, gjatë momentit të shoqërimit, 1000 lekë në mënyrë që ata ta linin të lirë, Gjykata e Posaçme ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe vënien në provë të shtetasit për 1 vit e 2 muaj.

8. Shkelja e barazisë në tendera

27 raste rezultojnë të monitoruara, ndërkohë që vetëm 15 raste ose rreth 56% konstatohen si të dyshuar për kryerjen e formës së pastër të kësaj figure të veprës penale. Ndërkohë në rastet e tjera, konstatohet një konkurrim ndërmjet ‘shkeljes së barazisë në tendera’ dhe ‘korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike’, ‘korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike’, ‘falsifikimit të dokumentave’ apo ‘shpërdorimit të detyrës’.

Ekspertët vlerësojnë se për shkak të rrezikshmërisë së veprës penale dhe dinamikës së përhapjes së saj në kohët e fundit, në asnjë rast organi i akuzës nuk ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Edhe në këtë rast vlerësohet pozitivisht proaktiviteti i SPAK, që ka sjellë arrestimin e funksionarëve të lartë shtetërorë, të përfshirë në procedura prokurimi publik, në shpërdorim të kompetencave të tyre por duke gjeneruar dhe dëme të konsiderueshme mbi interesin publik.

Në 12 raste rezulton se përfaqësuesit e prokurorisë kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme shkalla e I-rë në 11 raste,

ndërkohë 1 prej rasteve është ende në proces. Ky i fundit konsiston në hetimin e ndërmarrë nga SPAK ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për tenderin e ushqimeve. Kjo çështje është dërguar për kompetencë pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që personat nën hetim aktualisht janë pa asnjë masë sigurimi në fuqi, për shkak të refuzimit të kërkesës së prokurorit nga ana e Gjykatës. 3 prej rasteve, ndaj të cilave është kërkuar dhe caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” i korrespondojnë 3 zyrtarëve të Ndërmarrjes së Pasurisë Publike në Bashkinë Lushnjë, një prej të cilëve e gjinisë femërore. Të gjitha rastet e tjera i korrespondojnë materialeve të regjistruara ndaj anëtarëve të Njesisë së Prokurimit pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara në Ministrinë e Brendshme. “Blerja dhe shpërndarja e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit” është procedura e prokurimit e cila u realizua për llogari të autoritetit kontraktor “Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”. Të dyshuarit rezulton se në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me drejtuesin e organit qendror blerës, drejtor i Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara kanë cënuar rregullat procedurale të prokurimit publik, duke avantazhuar në mënyrë të padrejtë operatorin fitues. Gjykata e Posaçme shkalla I-rë caktoi masën e sigurimit “arrest në burg” ndaj 8 shtetasve, ndërkohë ndaj 1 shtetaseje u caktua masa e sigurimit “arrest në shtëpi”. Këto masa u lanë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Posaçme të Apelit.

Gjithashtu, 6 rastet në të cilat prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” janë aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme shkalla e I-rë dhe ajo e Apelit në 5 raste. Këto raste i korrespondojnë shtetasve të përfshirë në operacionet e lartpërmendura. Rasti më interesant vijon të mbetet ai i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në të cilin rezultonte i dyshuar si i përfshirë dhe kreu i rezervave të shtetit. Pavarësisht se prokuroria është treguar strikte në kërkimin e caktimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj njërit prej personave nën hetim, Gjykata e Posaçme ka refuzuar një kërkesë të tillë, duke e lënë shtetasin pa asnjë masë sigurimi personal. Kjo çështje i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që tenderi objekt shqyrtimi rezulton i

rëndësishëm sa kohë që i korresponдон loteve bazike për nevoja të emergjencës gjatë Covid-19.

Kërkesa për caktimin e masës ndaluese “pezullim i ushtrimit të detyrës a funksionit publik” rezulton të jetë depozituar nga ana e organit të akuzës njëkohësisht me kërkesën për gjykimin e të njëjtës çështje të sipërcituar që ka lidhje me Ministrinë e Mbrojtjes. Në të njëjtën qasje, Gjykata e Posaçme e ka refuzuar edhe këtë kërkesë, duke e lënë shtetasin pa asnjë masë sigurimi dhe duke kaluar për kompetencë çështjen Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë.

Në analizë të këtij rasti, duke respektuar sekretin hetimor të rrethanave faktike dhe të argumentimeve pjesë e dosjeve hetimore, ekspertët vlerësojnë se edhe në këtë rast duhet të kishte prevalencë vlerësimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer. Lënia pa masë sigurimi e shtetasve të dyshuar, drejtpërdrejtë të përfshirë në procedurën e prokurimit është një praktikë që krijon premisa për cënim të dispozitave ligjore në fuqi, pasi si në rastet e zyrtarëve publikë të përfshirë në procedura të tjera tenderimi, edhe në këtë rast mundësia e prishjes dhe ndryshimit të provave nuk është reduktuar.

9. Përfitimi i paligjshëm i interesave dhe fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë

Nga 6 rastet e monitoruara, në 2 raste konstatohet se Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Njëri prej rasteve i korresponдон kallëzimit të depozituar nga një avokat mbi një ish-prokuror të shkarkuar nga vettingu, i cili pretendohet se ka fshehur pasurinë, shpërdoruar detyrën dhe ka mashtruar. Si rrjedhojë, kallëzuesi kërkoi nga SPAK ndërmarrjen e hapave konkretë impaktues ndaj të shkarkuarve nga procesi i vettingut për mosjustifikim të pasurisë së tyre, duke sekuestruar pasurinë që ata dispononin. Edhe në këtë rast SPAK shpalli moskompetencën duke ia transferuar çështjen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila vendosi mosfillimin me argumentimin se ish-prokurori ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të të ardhurave, por hetimi i faktit nëse ky deklaram i rremë është kryer më dashje apo jemi përballë pasaktësive në plotësimin e deklarimeve nuk

mund të realizohet nisur nga përmbushja e afateve të parashikimit të ndjekjes penale.

Vetëm në 1 rast SPAK (Prokuroria) krahas kërkesës për gjykimin e çështjes ka kërkuar në Gjykatën e Posaçme edhe sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, për shkak se ky i fundit nuk e justifikon pasurinë me burime të ligjshme. Kjo çështje vijon ende të jetë në proces shqyrtimi gjyqësor.

Por Gjykata e Posaçme ka vendosur masën e sekuestros ndaj një ish-gjyqtari të Gjykatës së Lartë dhe ish-gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, të cilët janë shkarkuar në kuadër të procesit të vettingut. Ndaj këtyre ish-funksionarëve të sistemit të drejtësisë rëndon akuza e “refuzimit për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” parashikuar nga neni 257/a K.P. Pasuria e paluajtshme e vendosur nën sekuestro në secilin rast konsiston në një njësi/dyqan me sipërfaqe 172m² e ndodhur në Rr.Durrësit dhe pasuri e llojit truall e llojit karburant/pikë tregtimi me vendndodhje në shëtitoren Lungomare dhe Jonufër.

Gjithashtu, një qytetar rezulton të ketë kallëzuar në SPAK disa ish-përfaqësues të sistemit të drejtësisë, më konkretisht 4 ish-anëtarë të KLP-së, ish-drejtues të Prokurorisë dhe Prokurorë, ish-gjyqtarë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, Gjykatës së Apelit, Gjykatës së Lartë etj. Sipas pretendimeve të qytetarit, këta shtetas nuk e kanë kaluar procesin e vettingut, për shkak të deklarimit të pasurisë së pasaktë në disponimin e tyre. SPAK shpalli moskompetencën duke ia referuar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për akuzën e “shpërdorimit të detyrës” dhe “falsifikimit të dokumentave”. Sipas argumentimit të SPAK, nga kallëzimi i depozituar nuk ofrohet asnjë indicie dhe asnjë e dhënë që të mbështesë pretendimet e kallëzuesit për akuza të tjera.

KREU II


LUFTA KUNDËR DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

1. Lufta kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar

Progres Raporti i Komisionit European për vitin 2020, adresoi se vendi ynë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, por ende shumë rrugë është për t'u bërë. Forcimi i luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike duke përfshirë bashkëpunimin me Europol dhe vendet anëtare të Unionit; zbatimi i një plani të ri veprimi dhe një strategjie të përcaktuar mbi drogën, marrja e masave për plotësimin e boshllëkut legjislativ mbi prekursorët dhe intensifikimi i luftës kundër trafikimit të drogës mbeten ndër rekomandimet kyçe adresuar Qeverisë Shqiptare për vitet vijuese.¹⁹

Pavarësisht rëndësisë që ka lufta ndaj korrupsionit, ekspertët e Qendrës “Fol” kanë monitoruar një numër të lartë të materialeve të depozituara pranë organeve proceduese në fushën e drogërave. Më konkretisht 1320 raste ose rreth 69% e numrit total të materialeve, janë monitoruar nën këtë kategori.

Sa i përket volumit të materialeve të regjistruara rezulton se vepra




penale e
'prodhimit
dhe shitjes
së lëndëve
narkotike'
në formën e
saj klasike,
parashikuar
nga neni 283
K.P. është
dispozita në

¹⁹ Fq. 38. Link: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf

referim të së cilës janë depozituar numri më i lartë i materialeve. Më konkretisht 711 raste ose rreth 54% përkojnë me këtë dispozitë, ndjekur nga neni 283/1 K.P. me 476 raste ose rreth 36% dhe nga neni 284 K.P. me 58 raste ose rreth 4%.

Referuar shtrirjes në kohë, ekspertët kanë konstatuar se gjatë vitit 2020 janë regjistruar 227 raste, duke përfshirë 122 raste në muajin Nëntor 2020 dhe 105 raste në muajin Dhjetor 2020. Ndërkohë sa i përket vitit 2021, ekspertët kanë monitoruar fashikujt hetimorë dhe ato gjyqësore të 1093 rasteve ose rreth 83% e numrit total të materialeve. Sa i përket muajve në të cilat këto raste janë regjistruar, konstatohet se muajt Qershor 2021 (203 raste ose rreth 15%) dhe Shtator 2021 (172 raste ose rreth 13%) janë muajt në të cilat janë ndërmarrë operacionet më të rëndësishme në fushën e luftës kundër lëndëve narkotike. Ndërkohë ekspertët mbajnë parasysh se në të dhënat statistikore të muajit Janar 2021 duhet të mbahet parasysh dhe fakti se disa nga ngjarjet të regjistruara në periudhën e fundvitit janë regjistruar në këtë muaj.



Me synim ofrimin e një panorame objektive për secilën figurë të veprës penale, ekspertët e Qendrës “Fol” kanë përzgjedhur të

ndajnë me publikun të dhëna për secilën dispozitë.

2. Përfshirja e të rinjve dhe të miturve kërkon reflektim

Një sërë aktorësh vlerësohen nga ana e ekspertëve si ndikues në përfshirjen e të rinjve dhe të miturve të kryeqytetit në veprat penale në kategorinë e drogërave. Nga të dhënat e monitoruara konstatohen rreth 52 raste ose rreth 4%, në të cilat personat e përfshirë janë të mitur ose të rinj, të moshave 14-23 vjeç. Mbeten shqetësim veprat penale në të cilat këto të mitur rezultojnë të përfshirë, pa u kufizuar vetëm në “prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike” (neni 283 K.P.); “kultivimi i bimëve narkotike” (neni 284 K.P) etj. Vetëm 1 shtetas është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale të “nxitjes për përdorimin e drogës” të parashikuar nga neni 286 K.P., por në këtë rast subjekti viktimë i veprës penale ka qenë i mitur. Kryesisht Policia ka ndjekur qasjen e një drejtësie miqësore për të miturit, një parim themelor dhe standard i kërkuar nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur, duke arrestuar në flagrancë vetëm 21 shtetas, ndërkohë 31 të mitur ose rreth 60% e tyre rezultojnë të proceduar në gjendje të lirë.



Pjesa më e madhe e shtetasve të proceduar në gjendje të lirë fatkeqësisht rezultojnë emra të njohur për uniformat blu, për shkak të recidivizmit. Ekspertët vlerësojnë se mbetet për t'u analizuar nga ana e përfaqësuesve të mekanizmit të drejtësisë penale për të mitur funksionaliteti i masave dhe veprimeve të tyre, në raport me rehabilitimin e të miturve, pasi rikthimi i tyre në konflikt me ligjin është një proces i cili ndodh brenda një periudhe 1-2 mujore. Sa i përket të dhënave statistikore është konstatuar se vendimmarrjet e mosfillimit të procedimeve penale nga ana e organit të akuzës janë në mazhorancë, më konkretisht në 24 raste ose rreth 53% prokurorët zgjedhin që të mos vijojnë procesin hetimor. Shkak për këto vendimmarrje bëhen rezultatet e analizave Kimiko-toksikologjike, në bazë të të cilave vërtetohet fakti se i mituri është përdorues i rregullt i lëndëve narkotike. Ndërkohë arsyeja tjetër është


sasia e vogël e lëndës narkotike, një standard i përcaktuar nga ana e ligjvënësit, por edhe nga vetë IML nën masën 5 mg, i përcaktuar si i mjaftueshëm vetëm për përdorim vetjak.

Lloji i substancës apo lëndës narkotike të poseduar nga ana e të miturve të kapur dhe të referuar nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit rezulton në vend të parë kanabis dhe në një rast të shkëputur ekstazi. Referuar vendndodhjes në të cilën janë lokalizuar këta shtetas nga patrullat e policisë konstatohen si hotspot (“pika të nxehta”) të kryeqytetit Rr. Riza Cuka (e quajtur katrori); Rr. Stavri Themeli (afër ish Parkut); Rr. Ibrahim Rugova (Paskuqan); Yzberisht; Rr. Egnatia (Don Bosko); Rr. Baftjar Liçi (zona e Dajtit) dhe Zona e ish-Parkut (afër Bar Shqiponja) etj.

3. Figurat e veprave penale të konsumuara në fushën e drogërave

3.1. Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike sipas nenit 283 K.P.

Në 707 raste ose rreth 54% ekspertët kanë monitoruar materiale të referuara për “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike në formën klasike”, parashikuar nga neni 283 K.P.



Pjesa më e madhe e shtetasve janë proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë, më konkretisht 68% ose rreth 478 shtetas. Ndërkohë minoranca i përket shtetasve të arrestuar në flagrancë ose ndaj të cilëve është ekzekutuar masa e dhënë nga ana e Gjykatës në mungesë, më konkretisht në 32% të rasteve ose rreth 229 shtetas.

3.1.1.Vendimmarrjet e mosfillimit dhe kërkesat për pushimin e çështjeve nga ana e Prokurorisë

Përbën rëndësi që për 362 raste ose rreth 51%, të shtetasve të proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në asnjë prej këtyre rasteve nuk rezulton që vendimmarrja e prokurorisë të jetë atakuar në Gjykatë. Argumentimi i përdorur nga ana e prokurorëve në këto vendimmarrje, bazohet në 2 elementë: autorët e dyshuar janë përdorues prej viteve të lëndës narkotike, dhe doza e sekuestruar në momentin e kontrollit është e vogël, e përdorshme për përdorim vetjak, një kriter përjashtues bazuar në nenin 283/1 K.P. dhe Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, dt. 27.03.2008. Gjithashtu, nisur nga vendimmarrjet e Prokurorisë konstatohet se IML ka vendosur një kufi standard prej 5 gramë lëndë narkotike për ta konsideruar si dozë vetjake për përdorim personal.

Njërit prej shtetasve në zonën e Laprakës, ju gjet një grirëse me mbetje të lëndës narkotike. Policia e referoi në gjendje të lirë, ndërkohë që Prokuroria vendosi mosfillimin. Në urinën e tij u gjetën produkte kanabiniodike, por IML nuk depozitoi akt-ekspertimi kimik për lëndën e sekuestruar. Vetë Institucioni i Përkujdesit Shoqëror deklaroi se nevojitej një kohë e konsiderueshme për të kryer ekspertizat, për shkak të ngarkesës së lartë të punës.

Ekspertët vlerësojnë se roli i ekspertëve të IML-së në procedime të kësaj natyre është determinant dhe tepër i rëndësishëm, për këtë qëllim ekspertët rekomandojnë marrjen e masave nga ana e IML-së për shtimin e ekspertëve toksikologjikë, me qëllim përballimin e flukseve dhe shmangien e kufizimit të padrejtë të lirisë së shtetasve, të cilët mbeten në pritje për një kohë të gjatë deri në daljen e rezultateve të akt-ekspertimeve.


Sa i përket vendimmarrjeve të pushimit, ekspertët kanë monitoruar 13 raste, për të cilat organi i akuzës ka kërkuar në Gjykatë pushimin e çështjes penale. Ndaj 4 prej këtyre rasteve fillimisht është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës vetëm në 3 raste, ndërkohë në njërin prej rasteve

Gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurorit duke caktuar ndaj shtetasit masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. Ky rast i korrespondon 2 vëllezërve të cilët posedonin një ambient lokal, ku pas ndërmarrjes së një procedure kontrolli është gjetur një sasi lënde narkotike kokainë dhe një peshore elektronike. Kërkesa për pushim nga ana e organit të akuzës rezulton të jetë depozituar vetëm për njërin prej vëllezërve, adoleshent i cili nuk kishte dijeni për aktivitetin e të vëllait. Por në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (neni 83), Gjykata e Shkallës së Parë vendosi masën “vendosja e të miturit nën mbikqyrje”, një rol i cili iu besua nënës së tij.

Ndërkohë 2 raste të tjera, ku ndaj personave të dyshuar Gjykata kishte aprovuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me afat, në pritje të rezultateve të akt-ekspertimit toksikologjik. Të dy shtetasit rezultuan përdorues të lëndëve narkotike, por vetëm një prej tyre u provua gjatë fazës së hetimeve paraprake se ka poseduar sasinë e lëndës narkotike të sekuestruar në dhomën e hotelit, për përdorim vetjak. Gjykata e Apelit e vlerësoi të paligjshëm arrestimin e këtyre shtetasve, por ata vijuan të qëndronin nën masën e sigurimit “arrest në burg” për një tjetër ngjarje vjedhjeje të një njësie në Burrel.

3.1.2. Trendi i masave të sigurimit

3.1.2.1. Masa e sigurimit “arrest në burg”



Ekspertët kanë vërejtur se masa e sigurimit “arrest në burg” është kërkuar nga ana e prokurorit për 93 raste ose rreth 44%. Por vetëm për 82 raste kjo masë është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërkohë që kjo masë siguri u ruajt e pandryshuar deri në Gjykatën e Apelit për 40 raste. Pra siç konstatohet vërehet një përgjysmim i rasteve, pra një tendencë

zbutjeje e masës së sigurimit nga shkalla më e ulët në atë më të lartë të gjyqimit. Të gjithë shtetasit e dyshuar ndaj të cilëve është vendosur kjo masë siguri rezultojnë të jenë arrestuar nga ana e forcave të rendit, ndërkohë që lloji i lëndës narkotike që ju është sekuestruar është ai cannabis sativa ose kokainë ose heroinë.

Nën drejtimin e Prokurorisë së Tiranës, Policia ndërmori një operacion disa mujor, në kuadër të të cilit u arrestuan rreth 12 persona të grupmoshave 17-27 vjeç, ndërkohë që 6 shtetas të tjerë u shpallën në kërkim. Në kuadër të këtij procedimi penal u finalizua dhe operacioni “Kontakt”, ndërkohë që Policia përdori mjete të sofistikuar si dronë për dokumentimin e veprimtarisë kriminale të 22 shtetasve. Janë sekuestruar sasi me lëndë narkotike dhe shuma të konsiderueshme monetare, të përfituara nga shitja e lëndëve narkotike. Këta shtetas e zhvillonin aktivitetin e tyre në zonën ish-parkut, në rrugën “Ndre Mjeda” dhe në rrugën “Frosina Plaku”. Masat e sigurimit të dhëna u ankimuan nga ana e mbrojtësve ligjorë të të pandehurve, duke pretenduar se këto masa ishin caktuar në kundërshtim me parashikimet ligjore, bazuar vetëm në dëshmi të dhëna nga ana e blerësit të lëndës narkotike, i cili për shkak se shitësit kanë pasur kapuçë e ka pasur të pamundur që t'i

identifikojë. Ndaj 2 të miturve, 17 vjeçë u caktua masë në përputhje me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, ndërkohë që prokurori hoqi dorë nga e drejta e ushtrimit të ankimit edhe për 1 prej të dyshuarve i cili vuante nga epilepsia dhe një tjetër i cili ishte nxënës në gjendje tepër të vështirë ekonomike. Ankimet e depozituara në emër të 2 të bashkë-pandehurve, të cilët nga rrethanat e faktit konsiston se luajnë një rol kyç, janë nënshkruar nga ana e mbrojtëses ligjore në mungesë të një akti përfaqësimi.

Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe rrethanat e konstatuara në momentin e arrestimit në flagrancë duket se kanë fundosur disa të rinj. Punonjësit e Seksionit kundër Luftës ndaj narkotikëve arrestuan në rrugën “Llazi Miho” një shtetas i cili kishte aktivitet të shitblerjes së lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit të ushtruar u konstatuan se ata mbanin me vete lëndë të llojit ‘heroinë’. Gjithashtu, njëri prej shtetasve mbante dhe një kuti cilindrike me 22 kokrra metadon. Para hetuesve, i pandehuri deklaroi se *e blinte me 1000 lekë të vjetra gramin dhe ta shesë me 5000 lekë*. Përshtatshmëria e masës së sigurimit “arrest në burg” u la në fuqi nga ana e dy shkallëve të gjykimit.

Në lokalin “Ëest” në rrugën “Haxhi Kika” u sekuestruan rreth 338 gramë cannabis sativa dhe kokainë. Disa shtetas u arrestuan në këtë lokal, pasi gjatë kontrollit u konstatua se po konsumonin lëndë narkotike. Por hetimi për 3 shtetas u veçua dhe u pushua, për shkak se ata rezultuan përdorues të lëndës narkotike prej vitesh.

Mekanizmi i gjykimit të shkurtuar duket se ka shpëtuar në disa raste shtetasit e pandehur. Gjatë kontrollit fizik që iu bë një shtetasi, policia gjeti doza kokaine dhe cannabis, një telefon dhe peshore. Fillimisht u dënua nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me 6 vite burgim, por për shkak të pranimi të kërkesës për gjykim të shkurtuar iu reduktua dënimi në 4 vite. Ekzekutimi i dënimit me burgim u pezullua duke e vendosur në provë shtetasin e dënuar, me kushtin që të mos përfshihet në ngjarje dhe aktivitete kriminale.

Punonjës policie kanë rezultuar të përfshirë në vepra penale në fushën e narkotikëve, në bashkëpunim me shtetas të tjerë të njohur për uniformat blu si përdorues dhe shitës të lëndës narkotike. Në zonën e quajtur

“Parku i autobuzave” u arrestuan disa shtetas, ndër të cilët dhe një punonjës policie në repartin special “Renea”. Gjatë kontrollit u sekuestruan disa sende të paligjshme si, 434 gr.kokainë, 576 gr.cannabis sativa, 100.6 gr.lëndë narkotike e llojit ekstazi, 18.2 gr fara të dyshuara për kultivimin e bimëve narkotike, peshore dhe vlera të konsiderueshme monetare, armë zjarri etj. Oficeri i Reneas dyshohet se ka ndihmuar në shitjen e lëndës narkotike, ndërkohë që ai ra në pranga në kuadër të infiltrimit të një punonjësi të SHÇBA i cili u paraqit në blerjen e simuluar si blerës i interesuar. Dyshimet nga ana e organit procedues adresohen mbi punonjësin e forcave speciale, duke e targetuar atë si person kyç në shpërndarjen e lëndëve narkotike në zonat e Parkut të Autobuzëve, Yzberisht dhe qyteti i Nxënësve.

Në kuadër të finalizimit të suksesshëm të operacionit “Vila”, ranë në prangat e policisë 1 çift, të cilët kishin përshtatur ambientin e banesës së tyre me aparatura që shërbejnë për kultivimin dhe prodhimin e lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit në banesë u sekuestrua një sasi e konsiderueshme lënde narkotike, ndërkohë që në të dyja shkallët e gjyqimit, i pandehuri ka kërkuar zbutjen e saj, duke e argumentuar me gjendjen shëndetësore, familjare dhe situatën e përhapjes së Covid-19. Por duke u bazuar në rrezikshmërinë e veprës penale dhe dinamikës së përhapjes së saj, të dyja shkallët e gjyqimit nuk pranuan kërkesat e personit të pandehur, duke lënë në fuqi ndaj tij masën e sigurimit “arrest në burg”.

Në kuadër të operacionit anti-drogë “Urus” u arrestuan në flagrancë 2 shtetas, të cilët udhëtonin me automjetin e tyre në rrugën “Nikolla Lena”. Gjatë kontrollit iu sekuestruan një qese me lëndë narkotike kokainë në masën 1 kg 117 gr. Prokuroria kërkoi caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, kërkesë e cila u refuzua nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë duke caktuar atë të “arrestit në shtëpi”. Gjykata vlerësoi se kërkesa nuk ishte e drejtë, për shkak se nuk përmbusheshin kushtet e parashikuara nga neni 230 K.Pr.P., ndërkohë që shtetasi i arrestuar nuk rezultonte i dënuar më parë. Organi i akuzës e ankimoi këtë vendimmarrje, ndërkohë që Gjykata e Apelit vendosi zëvendësimin e masës së sigurimit dhe caktimin e masës “arrest në burg”, për shkak se

nga informacionet pjesë e dosjes gjyqësore rezultonte e provuar se shtetasit janë arrestuar në të njëjtin automjet me njëri-tjetrin, ndërkohë që ekzistojnë indicie të mjaftueshme të grumbulluara në rrugë operative se këta shtetas merren me shpërndarje të lëndës narkotike.

Edhe pse organi i akuzës kërkoi caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për një shtetas i cili realizonte lëvizje të dyshimta në zonën e “Petro Nini Luarasit”, Gjykata nuk e aprovoi një kërkesë të tillë duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. Pas kontrollit fizik që iu bë shtetasit në momentin e arrestimit iu gjetën disa qese, brenda të cilave gjenden boçe të llojit cannabis sativa në masën 4.6 gr. Para grupit hetimor, personi nën hetim pranoi se është përdorues i lëndëve narkotike, ndërkohë që sasia e cila i është gjetur në banesë është një dozë për përdorim vetjak. Ndërkohë pluhuri i bardhë i sekuestruar, sipas pretendimeve të të pandehurit është sodë buke, të cilën ai e përdorte për shkak të problemeve me stomakun. Por pavarësisht këtyre pretendimeve, ekspertët e IML konkluduan se sasia e lëndës narkotike e gjetur në banesë tejkalon standardin e përcaktuar për përdorim vetjak, duke bërë që organi i akuzës të depozitonte në Gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes.

3.1.2.2. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi”

Kjo masë siguri rezulton të jetë kërkuar nga ana e Prokurorisë në 19 raste, ndërkohë që kërkesat janë aprovuar në 18 raste nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Por në 1 rast Gjykata e Apelit ka zgjedhur të zbusë masën e sigurimit duke e zëvendësuar me atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Pasi shërbimet e forcës së posaçme “Shqiponjat” ushtruan kontroll në automjetin e një shtetasi, konstatuan një sasi të dyshuar lënde narkotike. I riu i arrestuar pretendoi se është përdorues i lëndës narkotike, ndërkohë që lëndën narkotike e ka blerë tek zona e “Kodrave të Liqenit”. Gjykata e Shkallës së Parë në momentin e caktimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” argumentoi se personi nën hetim nuk kishte të ardhura ekonomike për të blerë lëndën narkotike të llojit kokainë, e cila importohet me çmim të lartë nga vendet

europiane. Mbetet e paqartë në këndvështrimin e ekspertëve se çfarë e shtyu Gjykatën e Apelit për të zëvendësuar këtë masë sigurimi, ndërkohë që rehabilitimi i shtetasve përdorues të lëndëve narkotike vlerësohet si një element tepër i rëndësishëm.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” u la në fuqi nga ana e dy shkallëve të gjyqimit vetëm në 3 raste. Në njërin prej rasteve, Policia arrestoi një shtetas në moshë të re në zonën e Astirit. Nga kontrolli fizik u konstatuan 234 doza cannabis sativa, gati për shitje. Fillimisht Gjykata e Shkallës së Parë aprovoi kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” por personi nën hetim e shkeli këtë masë, pasi u konstatua në afërsi të një farmacie, me pretendimin se do të blinte ilaçe për nënën e tij të sëmurë. Prokuroria ankimoi vendimmarrjen në Gjykatën e Apelit duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit me atë të “arrestit në burg”, por Gjykata nuk e pranoi këtë kërkesë, duke vlerësuar se nuk ekzistojnë rrethana rënduese sa i takon veprës penale. Pas 1 muaji, ky shtetas u konstatua përsëri në ambiente jashtë banesës së tij, ulur në një stol, ndërkohë që prokurorja pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit ka kërkuar sërisht zëvendësimin e masës së sigurimit personal. Ky rast vijon të jetë në shqyrtim pranë kësaj Gjykate.

3.1.2.3. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Kjo masë sigurimi rezulton të jetë masa e kërkuar më së shumti nga ana e organit procedues, përkatësisht në 101 raste ose rreth 14%. Kjo masë sigurimi është caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë në të gjitha rastet, ndërkohë që gjykimi në Gjykatën e Apelit ka përfunduar vetëm për 8 raste duke mos sjellë zëvendësim të kësaj mase sigurimi.


Të gjithë shtetasit rezulton të jenë arrestuar në flagrancë nga ana e forcave të rendit, por pjesa më e madhe e tyre nuk rezulton të ketë ankimuar vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, nëpërmjet të cilës është caktuar kjo masë sigurimi. 8 shtetas të cilët kanë ankimuar vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, e kanë mbështetur ankimin e tyre në shkaqe familjare ose shëndetësore. Në një rast policia

konstatoi se një shtetas kishte përshtatur lokalin e tij për përdorim të lëndëve narkotike, ndërkohë që e mbante lokalin hapur jashtë masave kufizuese të vendosura nga ana e qeverisë gjatë periudhës së përhapjes së pandemisë globale Covid-19. Gjatë kontrollit në lokal u gjetën lëndë narkotike të llojit cannabis sativa dhe kokainë. Për njërin prej shtetasve të arrestuar të vendosur nën masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, avokati pretendoi se kjo masë ka rënduar gjendjen e tij ekonomike, për shkak se ai është baba i vetëm që duhet të kujdeset për mirëqënien e një fëmije të mitur. Nisur nga këto shkaqe, Gjykata e Apelit vendosi ndryshimin e masës së sigurimit, duke e zëvendësuar me atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Ekspertët vlerësojnë se publiku duhet të mbajë parasysh se pjesa e mbetur e rasteve prej 132 janë ende në fazën e hetimeve paraprake. Për shkak të sensitivitetit që i karakterizon këto raste, ekspertët nuk kanë mundur të grumbullojnë të dhëna shtesë, përveç statusit procedural të tyre, ky 19 shtetas rezultojnë të arrestuar në flagrancë ndërkohë 113 shtetas janë proceduar në gjendje të lirë nga ana e forcave të rendit.

3.2. Referimi i shtetasve sipas nenit 283/1 Kodit Penal

Regjistrimi i materialeve nën këtë dispozitë, vlerësohet nga ana e ekspertëve si një dispozitë homogjene, pra *modus operandi* i kryerjes së veprës penale nga ana e autorëve të dyshuar është në formën e saj origjinale.



Ekspertët kanë monitoruar 476 raste ose rreth 36% e numrit total të rasteve nën kategorinë e drogës. Rreth 379 shtetas ose rreth 80% e shtetasve janë proceduar në gjendje të lirë nga ana e Policisë,

ndërkohë 97 shtetas janë arrestuar në flagrancë.

3.2.1.Vendimmarrjet e mosfillimit dhe kërkesat për pushimin e çështjes

Në 243 raste ose rreth 96%, konstatohet se organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që në 10 raste ose rreth 4% është depozituar kërkesë për pushimin e çështjes pranë gjykatës, nga ana e prokurorëve të ngarkuar me shqyrtimin e çështjes.

1 shtetas i arrestuar në flagrancë në rrugën “Lord Bajron”, posedonte rreth 0.7 gr lëndë narkotike të llojit kokainë. Prokuroria vendosi mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që përfundoi në Gjykatë nën masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për shkak se drejtonte mjetin në gjendje të dehur, duke konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 291 K.P.

Edhe për këtë figurë të veprës penale, rezulton se organi i akuzës e bazon vendimmarrjen e tij të mosfillimit në faktin se autorët e dyshuar janë përdorues të lëndës narkotike prej shumë kohësh, ndërkohë që sasia e sekuestruar në momentin e kontrollit fizik është në doza të vogla, për përdorim vetjak.

2 shtetas të mitur në moshën 17 vjeç janë referuar në gjendje të lirë nga ana e Policisë, pasi janë konstatuar në rrugën “Ibrahim Rugova”, duke konsumuar lëndë narkotike të llojit hashash, secili në masën 0.6 gr. Adoleshentët kanë rezultuar përdorues të lëndës narkotike, referuar konkluzioneve të akt-ekspertimeve toksikologjike, ndërkohë që doza e sekuestruar në vendngjarje është konsideruar për përdorim vetjak.

Sa i përket 10 rasteve të monitoruara, ekspertët vlerësojnë se përfaqësuesit e organit të akuzës kanë vepruar në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 328 K.Pr.P dhe 329/a K.Pr.P. duke kërkuar pushimin e akuzës ose çështjes pranë gjyqtarit të seancës paraprahe. Edhe në këto raste kërkesa e organit procedues është bazuar në faktin se autorët rezultojnë përdorues të lëndës narkotike. Përbën interes fakti se në 7 raste, organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, masë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë në të gjitha rastet. Në

asnjë prej këtyre rasteve nuk rezulton që personat nën hetim të kenë apeluar masën e sigurimit të caktuar ndaj tyre.

3.2.2.Trendi i masës së sigurimit “arrest në burg”

Gjatë periudhës monitoruese ekspertët kanë konstatuar se në 39 raste ose rreth 8% të numrit total, Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj shtetasve. Por vetëm në 28 raste kjo kërkesë e organit të akuzës është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërkohë që deri në shqyrtimin e çështjes në shkallën e dytë (Apel) masa është ruajtur vetëm për 20 shtetas.

Kryesisht këto raste përkojnë me masa të konsiderueshme lënde narkotike të sekuestruar, element i cili vlerësohet si përcaktues i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit. Ndërkohë e veçantë konstatohet dhe mënyra e veprimit të autorëve në disa raste, të cilat reflektojnë perfeksionim të konsumatorëve dhe shpërndarësve të lëndës narkotike, zhvillim i cili përkthehet në kompleksitet për forcat e rendit. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar në banesën e një shtetasi pranë rrugës “Siri Kodra”, policia gjeti sasi të konsiderueshme lënde narkotike dhe monedha të falsifikuara. Brenda gojës së shtetasit të arrestuar u gjet dhe një qese transparente, e mbyllur me djegie, e cila përmbante pluhur të bardhë të llojit kokainë. Për shkak se ekzistonte rreziku i ikjes dhe i ndikimit në prova, Gjykatat vendosën lënien në fuqi të masës së sigurimit, pavarësisht se i riu pretendon se lëndën narkotike e ka për përdorim vetjak.

11 persona u arrestuan në operacionin “Galeria” të ndërmarrë pranë një lokali peshku në Rr. “Aleksandër Moisiu”. Në kundërshtim me oraret kufizuese të vendosura gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, në lokalin që mbahej hapur u gjetën sasi të konsiderueshme lënde narkotike e llojit kokainë dhe qese të mbyllura. Për shkak se nuk u vërtetua bashkëpunimi ndërmjet të bashkë-pandehurve, Prokuroria e ndau çështjen për një prej tyre. Pavarësisht se personi nën hetim pretendoi se është i vetmi që kujdeset për nënën e tij të moshuar, Gjykata vendosi lënien në fuqi të kërkesës së prokurorit.

Por në 2 raste vërehet se përfaqësuesit e sistemit gjyqësor (në të dyja shkallët e gjykimit) kanë lehtësuar pozitën procedurale të shtetasve të dyshuar si autorë të nenit 283/1 K.P., duke zbutur masën e sigurimit të kërkuar nga ana e prokurorit “arrest në burg” në atë “arrest në shtëpi”. Ndikuar nga recidivizmi në kryerjen e veprave penale në fushën e drogërave, në një rast personi nën hetim çenoi masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, duke bërë që Gjykata e Apelit të ndryshonte masën e sigurimit në atë “arrest në burg” duke i bashkëngjitur personit nën hetim dhe veprën penale të parashikuar nga neni 323 K.P. “largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Ndërkohë shtetasi tjetër ka “shpëtuar” nga masa e sigurimit “arrest në burg”, për shkak se sasia e lëndës narkotike e cila i është gjetur në posedim prej 0.6 gr me gjithë ambalazh është e vogël.

Ndërkohë masën e sigurimit “paraqitje në policinë gjyqësore”, pavarësisht kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” e gjejmë në rastin e një shtetasi të arrestuar në flagrancë nga forcat e rendit, të cilit i janë sekuestruar 3.4 gr cannabis sativa. Referuar akt ekspertimit toksikologjik ky shtetas është përdorues i lëndës narkotike, për këtë shkak është përjashtuar nga përgjegjësia penale, por është dërguar në gjykim për cënim të nenit 242 K.P. “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

3.2.3. Trendi i masës së sigurimit “arrest në shtëpi”

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” rezulton të jetë kërkuar nga ana e organit të akuzës në 6 raste. Në të gjitha këto raste kërkesa e depozituar nga ana e prokurorit është aprovuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, por shqyrtimi në apel bazuar në ankimimet e depozituara ka përfunduar vetëm për 2 raste duke lënë në fuqi të njëjtën masë siguri. Mbetet e paqartë për ekspertët rasti i një shtetasi të arrestuar në flagrancë nën akuzën “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” dhe “dhunë në familje”. Qasja humaniste e përdorur nga ana e organit të akuzës dhe përfaqësuesit e sistemit gjyqësor përballë dy akuzave të tilla vlerësojmë se duhet të ishte më proporcionale, duke synuar dhe parandalimin e ngjarjeve pasuese që shoqërojnë episodet e dhunës ndaj

anëtarëve të familjes. Ndërkohë rasti tjetër i përket një autoreje femër, e cila dyshohet e përfshirë në operacionin e ndërmarrë në “Skrapar”. Ekspertët vlerësojnë se për shkak të rrethanave cilësuese dhe shkaqeve familjare është zbatuar kjo qasje ndaj saj.

Nga bulevardi “Bajram Curri”, Policia ka ndjekur njësoj si në skemat e filmave një mjet të drejtuar nga një shtetas, i cili është ndaluar në rrugën “Donika Kastrioti”, por në momentin e ndalimit drejtuesi është larguar me vrap. Në një kuti të hedhur nga ana e shtetasit në oborrin e brendshëm të Kryesisë së Kuvendit janë gjetur 12 qese plastike me material të ngurtë të bardhë, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit kokainë në masën 5.6 gr. Rezulton se njëri prej shtetasve ka qenë nën ekzekutim të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” në momentin e ndalimit të automjetit. Pavarësisht se ai ka pretenduar se nuk ka dijeni për sasinë e lëndës narkotike, ndërkohë që i është dashur të dalë nga banesa për të marrë medikamente për fëmijën e sëmurë në farmaci, Gjykata e Shkallës së Parë ka konkluduar lënien në fuqi të masës së arrestit në shtëpi, duke bashkuar në ngarkim të personit të arrestuar dhe procedimin penal për nenin 242 K.P.

2.3.4. Masa më e përdorur ajo e ‘detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’

Ekspertët kanë konstatuar se në 48 raste ose rreth 10% prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Nga të dhënat statistikore, në raport me masat e sigurimit të sipërcituara, vlerësohet se ajo e detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore mbetet më e preferueshmja për organin e akuzës, por edhe për përfaqësuesit e sistemit gjyqësor pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, të cilët e kanë aprovuar këtë kërkesë në 46 raste. Një prej këtyre rasteve i korrespondon një shtetasi sirian 24 vjeçar, i integruar në vendin tonë prej 20 vitesh. Gjatë kontrollit fizik teksa drejtonte mjetin pa patentë i është gjetur një sasi prej lënde narkotike prej 5 gr kokainë, të cilën pretendonte se e kishte për konsum vetjak. Vetë i arrestuari nuk e apeloj masën e sigurimit, por gjatë shqyrtimit në Apel kërkoi vendosjen e masës “garanci pasurore”. Ndërkohë që Gjykata nuk pranoi kërkesën e tij, ajo shqyrtoi kërkesën për gjykim të depozituar nga Prokurori, duke

disponuar ndaj shtetasit dënimin me 5 vite burg, për akuzën e drejtimit të automjetit në gjendje të parregullt dhe prodhimin e shitjen e lëndëve narkotike. I akuzuari depozitoi ankim ndaj vendimit të themelit. Nga aktet pjesë e dosjes hetimore mbetet e paqartë nëse kjo vendimmarrje është bazuar në akt-ekspertimin toksikologjik, për shkak se masa e sekuestruar përkon me standardin e parashikuar nga vetë IML. Gjithashtu, mbetet e paqartë përse në këndvështrimin e përfaqësuesve të organit të akuzës nuk përbën rrezik ikjeje apo ndikim në procesin e grumbullimit të provave, lënia e këtij shtetasi nën masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”?! Neni 291 K.P. i cili dyshohet të jetë kryer nga ana e shtetasit nën masë sigurimi, është një krim me një marzh të lartë dënimi, për shkak të rrezikshmërisë së pasojave që mund të lindin, për këtë shkak vlerësohet se një masë e tillë sigurimi nuk është proporcionale, njëllë e zbatuar si në rastin e përdoruesve të sasive të vogla të lëndëve narkotike, të cilët nuk kryejnë asnjë vepër tjetër penale përveç kësaj të fundit.


3.3. Referimi i shtetasve të dyshuar për mbajtjen, shitjen ose shpërndarjen e lëndës narkotike në formën e bashkëpunimit ose më shumë se një herë, sipas nenit 283/2 K.P.

Në 32 raste konstatohet se shtetasit janë akuzuar se me veprimet e tyre kanë përmbushur elementët e kryerjes së veprës penale të mbajtjes, shitjes ose shpërndarjes së lëndës narkotike në rrethana cilësuese, pra në formën e bashkëpunimit ose më shumë se një herë, sipas nenit 283/2 K.P. Ekspertët vlerësojnë pozitivisht qasjen e organit të akuzës i cili në asnjë rast nuk ka vendosur mosfillimin e procedimit penal apo të ketë kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes, duke reflektuar në këtë mënyrë vendosmëri në ndëshkimin e autorëve të veprave penale me rrezikshmëri shoqërore në fushën e drogërave. Nga këto vetëm në 3 raste ose rreth 9% prokuroria ka depozituar në Gjykatë kërkesën për gjykim në themel të çështjes, ndërkohë që ndaj personave nën hetim ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, masë e cila është aprovuar nga ana e dy shkallëve të gjyqimit. Vetëm 3 shtetas janë proceduar në gjendje të

lirë nga ana e Policisë, ndërkohë që 29 shtetas janë arrestuar në flagrancë.

Ndër kërkesat për gjykim të depozituara në Gjykatë, tërheq vëmendjen rasti i një çifti bashkëshortësh, i arrestuar në autostradën “Tiranë Durrës”, teksa udhëtonin me automjetin e tyre në të cilin posedonin një sasi e konsiderueshme lënde narkotike dhe municione. Gjithashtu, lëndë narkotike është sekuestruar gjatë kontrollit të banesës së tyre, në masën 132.8 gr cannabis sativa. Fakti që implikimi i bashkëshortit është i vërtetueshëm dhe nisur nga rrezikshmëria shoqërore e tij, përfaqësuesit e sistemit gjyqësor në dy shkallët e gjykimit argumentuan domosdoshmërinë e masës së sigurimit “arrest në burg”.

3.3.1.Masa e sigurimit “arrest në burg”



Nga ana e ekspertëve të Qendrës “Fol” u monitoruan 17 raste në të cilat përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Ndërkohë kërkesa e prokurorit, është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë vetëm në 15 raste. Megjithatë Gjykata e Apelit ka ndryshuar qëndrim në 6 raste, duke bërë që statusi procedural i personave nën hetim të lehtësohet dhe masa e

sigurimit ndaj tyre të zbutet në atë të “arrestit në shtëpi”.

Ndër rastet të cilët kanë ruajtur statusin e tyre procedural dhe masën e sigurimit deri në Gjykatën e Apelit, është konstatuar se instituti i

gjykimit të shkurtuar ka qenë “zgjidhja” optimale, duke garantuar përfitimin e një ulje dënimi prej tyre deri në 2 vite burgim.

Masa e “arrest në burg” me afat 30 ditor është caktuar ndaj një shtetasi 20 vjeçar, i cili është arrestuar nga ana e forcave speciale “Shqiponja”, në posedim të të cilit është gjetur sasia e lëndës narkotike prej 47.2 gr cannabis sativa. Kjo masë sigurimi me afat u la në fuqi për shkak se të dyshuarit pretenduan që nuk u përket atyre droga dhe se duhet të kryhet akt ekspertimi kimik dhe toksikologjik për të vërtetuar autorësinë ose jo të tyre.

Njëri prej autorëve të dyshuar, të arrestuar në flagrancë në kuadër të operacionit “Xhamlliku” nuk ka pranuar që të referojë të dhëna përpara OPGJ-ve. Shtetasi i arrestuar rezulton pronar i një biznesi, ndërkohë që shpërndarja e lëndës narkotike realizohej nga ana e një shtetasi të paidentifikuar me motor picash. Duke pretenduar se grumbullimi i provave ka përfunduar, ndërkohë që ai nuk tenton të largohet dhe as të ndikojë në vërtetësinë e këtyre provave, i arrestuari kërkoi ndryshimin e masës së sigurimit duke e zëvendësuar me një më të lehtë. Duke vlerësuar ushtrimin me efektivitet të ndjekjes penale nga ana e organit të akuzës, të dyja shkallët e gjykimit lanë në fuqi masën e sigurimit “arrest në burg”.

Ndërkohë rastet e tjera në të cilat vërehet një zbutje e qasjes nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit, i bazojnë pretendimet e tyre në shkaqe familjare/shëndetësore, ose nga rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi nuk është konkluduar se shtetasi i dyshuar të ketë përgjegjësi të drejtpërdrejtë mbi ngjarjen. Një shtetas i arrestuar në flagrancë si posedues i një sasie prej 98.8 gr heroinë është lënë nën masën e sigurimit “arrest në shtëpi” nga ana e Gjykatës së Apelit, duke ndryshuar dhe zbutur masën e sigurimit “arrest në burg” të kërkuar nga ana e prokurorit dhe të caktuar nga ana e Gjykatës. Arsyeja e kësaj vendimmarrje rezulton të bazohet në dokumentacion mjekësor të lëshuar nga ana e mjekëve, që vërteton se i arrestuari vuan nga astma bronkiake, diagnozë e cila e shndërron në të pamundur ekzekutimin për një kohë të gjatë të masës së sigurimit.

3.3.2.Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” u kërkuar nga ana e prokurorisë në 12 raste, kërkesa të cilat u aprovuan edhe nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Por vetëm 3 shtetas ankimuan këtë masë sigurimi, ndërkohë që Gjykata e Apelit la në fuqi të njëjtën masë ndaj tyre. Në një rast, shtetasi i arrestuar në Rr. “Demneri” u kap nën posedimin e 3.8 gr cannabis sativa dhe 1 gr kokainë. Ai pretendoi se lëndat narkotike është e tija për shkak se është përdorues prej 3 vitesh i saj. Ndër të tjera ai shtoi se *“duke qenë se nuk kishte pasur para për blerjen e lëndës narkotike të llojit kokainë, ka ofruar telefonat e tij”*.

Ndërkohë një tjetër rast i përket bashkëshortes, e cila u arrestua ndërkohë që udhëtonte me bashkëshortin e saj në një automjet me municione dhe lëndë narkotike (shih më lart). Lidhur me lëndën narkotike të gjetur në banesë, ajo pretendoi para hetuesve se *“e dinte që bashkëshorti i saj është konsumator jo i shpeshtë. Ndërkohë njërin prej armëve e mbante për bukuri se është antike, kurse tjetra është me ajër”*. Për shkak të gjendjes familjare dhe fëmijëve të mitur të cilët kishin nevojë për përkujdesje, përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë penale kërkuar dhe caktuan ndaj saj masën e sigurimit sipas nenit 234 K.Pr.P.

Një tjetër rast interesant ka ndodhur me një 23 vjeçar, i cili është ndaluar nga ana e Policisë në kuadër të një urdhëri kontrolli fizik. Njëkohësisht forcat e rendit kanë ndaluar dhe një tjetër makinë, pasagjeri i së cilës në momentin e ndalimit i ka lënë në dorë të arrestuarit një qese me 2.1 gr lëndë e dyshuar kokainë. I arrestuari ka tentuar të fshehë sendin, por është pikasur nga ana e forcave të rendit. Për shkak se nuk kishte dijeni mbi atë çfarë pasagjeri i makinës tjetër i ka lënë në dorë, dhe nisur nga fakti që ai nuk e njeh shtetasin tjetër, Gjykata e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

3.4. “Trafikimi i narkotikëve” dhe “Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës”

Për të dyja këto figura të veprave penale, ekspertët kanë monitoruar 29 raste, përkatësisht 25 raste për “trafikimin e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a K.P. dhe 4 raste të dyshuar si “krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës” të përcaktuar në nenin 283/b K.P.

Vendimmarrjet e organit të akuzës për mosfillimin e procedimit penal janë regjistruar vetëm në 1 rast sa i përket nenit 283/b K.P., ndërkohë që shtetasi i dyshuar rezultonte i proceduar në gjendje të lirë. Ndërkohë sa i përket rasteve të regjistruara nën trafikimin e lëndëve narkotike, organi i akuzës nuk ka vendosur në asnjë rast mosfillimin e procedimit penal, por as nuk ka depozituar kërkesë për gjykim.

Në një rast shtetasi i moshës 58 vjeç u arrestua në flagrancë nën dyshimin se kishte përshtatur lokalit për përdorim dhe konsum të lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit fizik në ambientin në pronësi të të arrestuarit, pranë pallateve “Moskat” u gjetën sasi të lëndëve narkotike të llojit kokainë, të ndarë në disa qese dhe disa pipëza që shërbenin për thitjen e saj. Krahas kërkesës për gjykimin e çështjes, prokurori depozitoi në Gjykatë kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, kërkesë e cila u aprovua nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Akuza e “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” u hodh poshtë nga ana e Gjykatës, për shkak se lënda në masën 0,2 gr rezultoi e përshtatshme për përdorim vetjak, ndërkohë që në vendngjarje nuk u konstatuan prova se i arrestuari e shiste lëndën narkotike. Ndërkohë i arrestuari u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale nën nenin 285/a K.P. “përshtatja e lokalit për përdorim droge” duke e dënuar me 1 vit burgim, i ekzekutueshëm në 8 muaj pas kërkesës për gjykim të shkurtuar të aprovuar nga ana e Gjykatës. Gjykata e pezulloi dënimin me burgim, duke e zëvendësuar me atë të dënimit alternativ vënie në provë për një periudhë 18 mujore.

3.4.1. Masa e sigurimit “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi”

Sa i përket veprës penale të ‘trafikimit të lëndëve narkotike’ u konstatua se në 22 raste organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit

“arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Por në Gjykatën e Apelit kanë vijuar procesin vetëm 19 raste, për të cilat është vendosur lënia në fuqi e të njëjtës masë, asaj të “arrestit në burg”. Vetëm në 1 rast konstatohet që për këtë vepër penale, prokuroria të ketë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, kërkesë e cila nuk është pranuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë duke caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Ky rast i korrespondon operacionit të koduar “Mersin”, ku në një kontenier në portin e Durrësit ekzistonin indicie dhe informacione se fshihej një sasi e konsiderueshme lënde narkotike prej 49 kg kokainë. Sasia në cilësinë e provës materiale u bë e mundur që të sekuestrohej, pasi si rezultat i kontrollit të imtësishëm në bashkëpunim me autoritetet doganore, në njërin prej kontenierëve të ngarkuar me banane të nisur nga Ekuadori me destinacion Shqipërinë, për llogari të një firme me qendër në Maminas. Për këtë rast Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka shpallur moskompetencën, duke dërguar aktet në SPAK, nën akuzën e grupit të strukturuar kriminal.

Në 2 raste ekspertët kanë konstatuar një konkurim ndërmjet veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a K.P. dhe 328 K.P. Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë, në bashkëpunim me Policinë Kufitare Kapshticë dhe SHÇBA Korçë, në sajë të operacionit policor të koduar “Lugina”, kanë arrestuar në flagrancë 3 shtetas. Këta shtetas, në momentin që janë konstatuar nga shërbimet e Policisë Kufitare të PKK Kapshticë dhe ato të Frontex-it, kanë hedhur në tokë 2 çanta shpine, brenda të cilave kishte një sasi prej 10 kg lëndë të dyshuar kanabis, të dyshuar për t’u trafikuar në drejtim të Greqisë. Fillimisht ndaj njërit prej shtetasve të arrestuar është caktuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë masa e sigurimit “arrest në burg” me afat 40 ditor. Në përfundim të këtij afati, duke qenë se organi i akuzës nuk paraqiti prova shtesë, u realizua zëvendësimi i masës së sigurimit në atë “arrest në shtëpi”. Ndërkohë nga përgjimet ndërmjet 2 bashkë-pandehurve, janë interceptuar biseda ku kërkoheshin vota nga të afërmit dhe miqtë, në favor të një subjekti politik. Për këtë shkak SPAK ka regjistruar procedimin penal ndaj këtyre shtetasve nën nenin 328 K.P. “korrupsioni aktiv në zgjedhje”.

Ndërkohë 16 shtetasit e tjerë të arrestuar në kuadër të operacionit të koduar “Shpirti” janë lënë nën masën e sigurimit “arrest në burg”, masë e cila fillimisht rezulton të jetë caktuar në mungesë nga ana e Gjykatës së Posaçme. Më datë 4 Korrik 2021, kjo masë u konfirmua sërish ndaj shtetasve të hetuar në mungesë.

2 shtetas u arrestuan nga ana e Policisë, të dyshuar si drejtues të një linje trafiku të heroinës nga Shqipëria në Greqi. Sipas hetimeve të ndërmarra nga SPAK, rezultoi se aktiviteti i tyre është shtrirë edhe në Maqedoninë e Veriut, më pas lënda narkotike dërgohej në Greqi dhe më pas eksportohej drejt vendeve të BE-së. Shtetasit u dyshuan si autorë të veprave penale të parashikuara nga nenet e legjislacionit material penal si 283/a “Trafikim i narkotikëve”; 283/2 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve në rrethana cilësuese”; 333/a “grup i strukturuar kriminal” dhe 334 “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.


3.4.2. Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Kjo masë siguri rezulton të jetë kërkuar nga ana e Prokurorit në 4 raste të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës” parashikuar në nenin 283/b K.P. Gjykata e Shkallës së Parë rezulton të ketë pranuar këtë kërkesë vetëm në 1 rast i sipërcituar. Kjo është e vetmja masë siguri e kërkuar nga ana e organit të akuzës dhe e caktuar nga ana e Gjykatës.

3.5. “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “organizata kriminale”

Në total u monitoruan 66 raste, të dyshuar si autorë për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 284 “kultivimi i bimëve narkotike”, 284/a “organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale” dhe 284/c “Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope”. Organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal vetëm në 1 rast, ku dy shtetas janë referuar në gjendje të lirë si të dyshuar për kryerjen e veprës penale nën nenin 284/a K.P. gjithashtu, vetëm në 1 rast organi i akuzës ka kërkuar në Gjykatë pushimin e çështjes. Ky rast i përket njërit prej të bashkë-pandehurve të operacionit “Gomeni”, në

zbatim të të cilit u vendosën nën hetim 14 persona, 8 prej të cilëve u arrestuan, ndërkohë ndaj 4 personave Gjykata caktoi masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, ndërkohë 2 të tjerë u vunë nën detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore. Prokurori për këtë rast kërkoi caktimin e masës “garanci pasurore” bazuar në nenin 236 K.Pr.P., por kjo kërkesë nuk u aprovua nga ana e Gjykatës së Apelit e cila në fuqi masën e sigurimit “arrest në burg” të caktuar më parë nga Gjykata më e ulët hierarkike.



Vetëm për 14 raste ose rreth 21% të numrit total të rasteve të monitoruara, prokuroria ka grumbulluar provat bindëse për të depozituar kërkesë për gjykim në Gjykatë.

3.5.1.Masa e sigurimit “arrest në burg”

Sa i përket masës së sigurimit “arrest në burg” rezulton se përfaqësesi i organit të akuzës ka kërkuar caktimin e kësaj mase siguriimi për 37 raste, ndërkohë që në të gjitha rastet kjo kërkesë është lënë në fuqi nga Gjykata e Shkallës së Parë. Ndërkohë Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi të njëjtën masë për 24 raste. Në 9 raste, Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit “arrest në burg” duke e zbutur në atë të “arrestit në shtëpi”. 3

prej këtyre rasteve i përkasin shtetasve të përfshirë në operacionin e Gomenit. Grupi kriminal rezultonte nën përgjim dhe hetim prej qershorit të vitit 2020. Në rrethit e Krujës, më 26 qershor forcat e rendit ndërmorën një aksion për sekuestrimin dhe asgjësimin e 6 bimëve narkotike. Ndërkohë më dt. 27 gusht, policia konstatoi 40 rrënjë bimë narkotike me lartësi 1-1.8 m. Ky grup u godit përsëri më 17 shtator, gjatë këtij operacioni iu sekuestruan 95 bimë cannabis sativa. Masa e sigurimit e kërkuar nga prokuroria në këto raste ishte ajo e “arrestit në burg”, kërkesë e cila u aprovua nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, por Gjykata e Apelit vendosi masën e sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj 3 të bashkë-pandehurve, të moshës 30 – 55 vjeç. Kërkesa e personave nën hetim për të ndryshuar masën e sigurimit me një më butë, u aprovua edhe nga ana e Prokurorit të Apelit, si rrjedhojë Gjykata e Apelit mbajti qëndrimin se nuk mund të caktonte një masë më të rëndë se ajo e kërkuar nga ana e prokurorit.

Zbutja e masës së sigurimit personal nga ajo e “arrestit në burg” në atë “arrest në shtëpi” nga ana e Gjykatës së Apelit, argumentohet mbi shkaqe familjare apo shëndetësore. Por këto argumentime duhet të jenë të bazuara në indicie dhe prova të mjaftueshme. Interesant shfaqet rasti i të bashkëpandehurit të arrestuar në operacionin “Kashari”. Bashkëpunëtori 56 vjeçar pretendoi se vuan nga sëmundje të shëndetit mendor si rrjedhojë nuk mban përgjegjësi për veprën penale, por gjatë fazës së hetimeve paraprake asnjë akt provues nuk u depozitua mbi këtë diagnozë. Por pavarësisht kësaj artifice, Gjykata e Apelit vendosi zëvendësimin e masës së sigurimit në atë të “arrestit në shtëpi”.

3.5.2. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” rezulton të jetë kërkuar nga ana e organit të akuzës në 8 raste, por vetëm në 5 prej këtyre rasteve kjo kërkesë ka përmbushur pritshmëritë e përfaqësuesve të Gjykatës së Shkallës së Parë, të cilët kanë vendosur të pranojnë kërkesën. Gjykimi në Gjykatën e Apelit, gjatë periudhës së monitorimit, është finalizuar vetëm për 2 raste në të cilat Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Një prej këtyre rasteve i përket njërit prej

shtetasve të arrestuar nën operacionin “Shpirti”. I arrestuari dyshohet se ka marrë pjesë në organizimin dhe drejtimin e organizatës kriminale, parashikuar nga neni 284/a K.P. Ekspertët vlerësojnë se pavarësisht rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit, publiku duhet të mbajë parasysh proporcionalitetin e caktimit të masës së sigurimit, në raport me rrethanat faktike të çështjes objekt gjykimi. Edhe pse dosja hetimore e çështjes së përzgjedhur është sekrete dhe ende grupi hetimor ndodhet në fazën e grumbullimit të provave për gjykimin në themel të shtetasve ndaj të cilëve ky operacion u ndërmor, ekspertët vlerësojnë se roli i secilit të bashkë-pandehur duhet të analizohet rast pas rasti, në raport me ngjarjen.

Vetëm 3 raste ndaj të cilëve Prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, por Gjykata e Shkallës së Parë ka caktuar ndaj tyre masën “arrest në burg”, konstatohet se Gjykata e Apelit ka përzgjedhur lehtësimin e pozitës procedurale dhe zëvendësimin e masës me atë “arrest në shtëpi”. Këto raste i përkasin operacionit “Gomeni”, të trajtuar sa më lart.

Prokuroria në 5 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kryesisht shtetasit e përfshirë në këto raste rezultojnë të bashkë-pandehur, ndërkohë që roli i tyre në realizimin e veprës penale nuk ka rezultuar nga hetimi që të ketë qenë i një niveli të tillë sa të aplikohen masa siguri “arrest në burg” apo “arrest në shtëpi”. Në 1 rast, shtetasi i arrestuar është kryeplak i një fshati, i cili sipas kompetencave ligjore duhet të kishte realizuar kontroll në juridiksionin territorial të fshatit mbi kultivimin e lëndëve narkotike, por nuk konstatohet që të ketë përmbushur efektivisht një rol të tillë. Njëlloj si në operacione të tjera të rëndësishme edhe zyrtari vendor i përfshirë në operacionin “Qafmolla” rezulton se është përfshirë në këtë ngjarje nga mungesa e dijenisë, e cila ka ardhur si rrjedhojë e neglizhencës në kryerjen e detyrës prej tij. Ndërkohë shtetasi tjetër i përfshirë në këtë ngjarje, ka deklaruar se *“farat i ka blerë në Tiranë dhe i ka mbjellur, pa e ditur se çfarë janë”*.

3.5.3.Organizata kriminale

Për shkak të rëndësisë që një sërë ngjarjesh kanë pasur përballë përceptimit të publikut, por që kanë shërbyer edhe për testimin e veprimtarisë dhe funksioneve nga SPAK, ekspertët kanë monitoruar 12 raste të kategorizuara si krim i organizuar. Këto raste janë regjistruar nën veprat penale të “grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a K.P. dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” normuar nëpërmjet nenit 334 K.P.

Këto raste i përkasin emrave të rëndësishëm në botën e krimit, të cilët kanë qenë nën hetimin e SPAK prej kohësh, ndërkohë që veprat penale për të cilat ata dyshohen se janë autorë reflektohen si të mirë-organizuara prej tyre, sa kohë që hetimi i këtyre ngjarjeve i ka kushtuar SPAK përdorimin e teknikave dhe praktikave hetimore të specializuara.

6 prej këtyre rasteve i përkasin të njëjtit procedim penal, ndërkohë që pjesa e mbetur rezultojnë të bashkë-pandehur në të njëjtën çështje. Masa e sigurimit për të gjitha rastet e kërkuar nga ana e prokurorisë rezulton “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme në të gjitha rastet, por vetëm për 4 raste Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi të njëjtën masë. Procesi vijon ende pranë Gjykatës së Apelit për 8 rastet e tjera. Ndërkohë në 2 prej këtyre rasteve, që i përkasin të njëjtit procedim penal, prokurori ka depozituar në Gjykatë kërkesën për gjykimin në themel të çështjes objekt shqyrtimi. Këto masa siguri nuk duket se janë efektive, pasi në 1 rast shtetasi është larguar drejt Dubait, duke bërë që masa ndaj tij “arrest në burg” të mos ekzekutohet, por interesat e tij ligjore të vijnë në përfaqësohen në proces nga ana e mbrojtësit ligjor të zgjedhur prej tij. Bazuar në hetimet dhe dëshmitë e disponuara nga ana e organit të akuzës rezulton se ky shtetas ka porositur një vrasje, si pasojë e larjes së hesapeve të vjetra, që lidhen me hakmarrjen. Prokurorisë së Elbasanit i janë dashur rreth 2-3 vite për të ndërmarrë hetime të gjithanshme, ndërkohë që në vitin 2021 kjo dosje rezulton të jetë regjistruar nën kompetencën e SPAK.

Sa i përket të bashkë-pandehurve në procedimin tjetër të regjistruar po nën kompetencën e SPAK konstatohet se 6 shtetas u vunë nën hetim, pas

dy ngjarjeve kriminale të ndodhura në vitin 2005, përkatësisht në autostradën Tiranë-Durrës dhe ndaj një biznesmeni të fuqishëm i cili mbeti i vdekur si pasojë e atentatit me lëndë plasëse në kabinën e ashensorit të banesës së tij. Në dallim nga procedimi penal i analizuar më lart i cili reflekton një linjë konstante në metodologjinë e grumbullimit të provave dhe ndërmarrjes së akteve procedurale gjatë fazës së hetimeve paraprake, në këtë rast situata ishte tërësisht e ndryshme. Fillimisht hetimet ndaj këtyre shtetasve u pezulluan për moszbulim të autorëve të veprës penale. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka rifilluar hetimet e këtyre procedimeve dhe pas regjistrimit të tyre në regjistrin e procedimeve penale ka vendosur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm. Pas rifillimit të hetimeve, Prokuroria e Posaçme grumbulloi prova të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme në lidhje me autorët e këtyre dy ngjarjeve të rënda kriminale. Më tej Prokuroria ju drejtua Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me kërkesën për caktim mase sigurimi ndaj 6 të dyshuarve. Pas shqyrtimit të kërkesës, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me vendimin nr.115 datë 02.12.2020 ka caktuar masat e sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasve të dyshuar, të akuzuar ndër të tjera për një sërë veprash penale në konkurim me njëra-tjetrën si “vrasja me paramendim” (neni 78 K.P.); “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” (neni 278 K.P.) etj.

Nga të dhënat e reflektuara në dosjen hetimore rezulton se operacioni i ndërmarrë ndaj këtij grupi kriminal është bazuar në dëshminë e një bashkëpunëtori të drejtësisë. Pavarësisht provave të shumta të grumbulluara, rezulton se i dyshuari kryesor është ende në kërkim, pavarësisht se përfaqësuesi i sistemit gjyqësor ka vendosur ndaj tij masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. Ngjarjet e ndodhura në vendin tonë të kategorizuara nën krimin e organizuar pasqyrojnë në praktikë lidhjet e forta shoqërore ndërmjet të bashkë-pandehurve dhe interesa të shumëfishta dypalëshe të përkthyer në formën e “ndereve”, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që respekti të vlerësohet në nivelin e duhur. Por ndërkohë në thelb të grupeve kriminale, konstatohet përdorimi në praktikë i kodeve të heshtjes, element që vërtetohet me

faktin se të gjithë anëtarët e grupit të arrestuar dhe aktualisht nën ekzekutim të masës së sigurimit “arrest në burg” vijojnë të hedhin poshtë akuzat ndaj tyre, ndërkohë që rëndësi paraqet dhe instituti i ‘besës kanunore’. Në këtë rast, bashkëpunëtori i drejtësisë ka shprehur para hetuesve rrethana që e vërtetojnë këtë konkluzion *“atentat i perealizuar nga unë për arsye se hasmi im mbante me vete fëmijët e tij dhe unë nuk lejova shpërthimin sepse nuk doja të vrisja fëmijët”*.

3.6. “Përshtatja e lokalit për përdorim droge” dhe “nxitja për përdorimin e drogës”

Vetëm 2 raste janë monitoruar si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “përshtatjes së lokalit për përdorim droge” parashikuar nga neni 285/a K.P. Njëra prej shtetasve është e gjinisë femërore, por rezulton që është përfshirë në këtë ngjarje pasi lokali ka qenë nën administrimin e saj. Për shkak të mungesës së dijenisë prej saj, të dyja shkallët e gjykimit kanë aprovuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Ndërkohë “nxitja për përdorimin e drogës” rezulton një vepër penale e dyshuar si e konsumuar vetëm në 1 rast. Të dyja Gjykatat kanë lënë në fuqi masën e sigurimit të kërkuar nga ana e prokurorit, “arrest në burg”. Ekspertët vlerësojnë se për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të autorit dhe veprës penale, kjo masë është proporcionale pavarësisht moshës si i ri 25 vjeçar të të pandehurit. Ky procedim i korrespondon abuzimit seksual të një të miture në një fshat të Ersekës, të cilën i arrestuari ka detyruar që t’i ofrojë lëndë narkotike. Autori i dyshuar i kësaj veprë penale është proceduar edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 101 K.P. “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”.

Rekomandime

I. Në luftën kundër korrupsionit:

- a) Procedimi i shtetasve në gjendje të lirë, për vepra penale nën kategorinë e korrupsionit nxit në analizimin e disa faktorëve, të cilat rekomandojmë që të mbahen parasysh në mënyrë proporcionale rast pas rasti, si: politika penale humaniste drejt tendencës për ekzekutimin në nivele më të reduktuara të masave të sigurimit; niveli i lartë i pandëshkueshmërisë në rastin e veprave penale në fushën e korrupsionit; mungesa e kapaciteteve të autoriteteve proceduese për të ngritur akuzën mbi bazën e indicieve dhe provave përtej çdo dyshimi të arsyeshëm; ose perfeksionimi i mënyrës së kryerjes së veprës penale nga ana e ish-funksionarëve apo funksionarëve aktualë të lartë në institucione të nivelit qendror apo vendor, të cilët e shndërrojnë në të pamundur arritjen e objektivit për vënien para përgjegjësisë të autorit konkret.
- b) Krahas rëndësisë që SPAK ka fituar në raport me rikthimin e besimit tek qytetarët, rekomandojmë ndërmarrjen e hapave konkretë dhe objektivë nga ana e SPAK për hetimin dhe gjykimin e çështjeve në fushën e korrupsionit, me impakt për interesin publik, brenda afateve të arsyeshme kohore. Në këtë këndvështrim, informimi në kohë reale i publikut nuk duhet nënvlerësuar.
- c) Përfaqësuesit e organit të akuzës duhet t'i kushtojnë rëndësi argumentimit të vendimmarrjeve të mosfillimit të çështjes apo procedimit penal. Zvarritja e çështjeve të ndryshme nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, e cila mund të jetë ndikuar edhe nga dinamika e reduktuar e procesit të vettingut dhe vakancat e krijuara për një kohë të gjatë në sistemin gjyqësor, duhet të jenë proporcionale duke mos prodhuar cënim në thelb të së drejtës. Dhënia e drejtësisë brenda afateve të arsyeshme kohore, është një nga komponentët thelbësorë të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 6 KEDNJ. Për këtë qëllim, sugjerojmë që vendimmarrja e organit të akuzës për mosfillimin e këtij procedimi penal nuk duhet të fokusohet vetëm në anën subjektive të faktorëve që mund të kenë nxitur kallëzuesin në depozitimin e kallëzimit, por

duhet të reflektojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe objektive, duke promovuar tek publiku rëndësinë e garantimit të procesit të rregullt ligjor.

- d) Sugjerohet unifikimi i vendimmarrjeve sa i përket kërkesave për masat e sigurimit të depozituara nga ana e Prokurorisë, në rastet e personave të dyshuar nën akuzën e “shkeljes së barazisë në tendera”, duke mbajtur parasysh kriteret e përcaktimit të masave dhe shmangien e premisave për ndikim në procesin hetimor, ndërkohë që ata vijojnë funksionet e tyre publike në kontakt të vazhdueshëm me provat dhe indiciet objekt hetimi.
- e) Hetimi dhe gjykimi i krimeve zgjedhore sugjerojmë që të realizohet brenda afateve të arsyeshme, në mënyrë objektive dhe të gjithanshme, sa kohë që nuk humbet aktualiteti i rivendosjes në vend të së drejtës së cënuar, duke nxitur vënien përpara përgjegjësisë të personave përgjegjës, qofshin ata dhe funksionarë publikë.
- f) Hapa konkretë duhet të ndërmerren në bashkëpunim me aktorët e shoqërisë civile dhe faktorin ndërkombëtar, për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve nëpërmjet edukimit ligjor të tyre mbi krimet zgjedhore, veprat penale në fushën e lëndëve narkotike dhe psikotrope, korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- g) Sugjerohet ndërmarrja e masave për forcimin e planeve dhe strategjive në favor të policimit në komunitet, një praktikë e suksesshme në luftën kundër korrupsionit vertikal dhe atij horizontal.
- h) Në rastet kur institucionet publike janë depozitues të kallëzimeve penale, sugjerojmë ndërmarrjen proaktive të të gjitha hapave proceduralë për ankimimin e vendimmarrjeve të mosfillimit të Prokurorisë, duke ja besuar shqyrtimit gjyqësor.
- i) Rekomandohen ndërmarrja e përpjekjeve të përbashkëta nga aktorët pjesë e mekanizmit të ofrimit të drejtësisë penale, për të diskutuar rreth sfidave të konstatuara gjatë zbatimit të reformës në drejtësi dhe impaktin e tyre në raport me qytetarët, si dhe metodologjinë që duhet të ndiqet për arritjen e rezultateve konkrete dhe eficiente në luftën ndaj korrupsionit.

II. Në luftën kundër lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar:

- a) Organet proceduese pranë juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK duhet të zgjerojnë hetimet sa i përket veprave penale të kategorizuara si krim i organizuar. Hetime të detajuara, në raport me perfeksionimin e mjeteve dhe teknikave të hetimit duhet të vihen në zbatim, si një masë e efektshme ndaj perfeksionimit të mënyrës së realizimit të veprave penale nga ana e organizatave kriminale dhe grupeve të strukturuar.
- b) Të ndërmerren hapa konkretë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, mbi vënien në zbatim të një mekanizmi të mirë-administruar dhe funksional ndërmjet institucioneve penitenciare dhe njësive të qeverisjes vendore, në favor të rehabilitimit dhe ri-integrimit të shtetasve në shoqëri pas kryerjes së dënimit, me synim shmangien e recidivizmit.
- c) SPAK dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë duhet të marrin hapa në hetimin pro-dinamik të çështjeve të identifikuar në fushën e lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar, duke individualizuar përgjegjësinë penale për secilin të bashkë-pandehur sipas rolit të luajtur.
- d) Të nxitet partneriteti ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të specializuara të shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve dhe trajtimeve ndaj shtetasve të mitur (por jo vetëm), të cilët vuajnë nga varësia nga lëndët psikotrope dhe narkotike.
- e) Të rritet bashkëpunimi dhe kordinimi i insitucioneve përgjegjëse në luftën kundër abuzimit me substance narkotike.
- f) I rekomandohet Ministrisë së Arsimit inicimi i fushatave ndërgjegjëse në shkolla, lidhur me pasojat nga përdorimi i substancave narkotike, me synim fuqizimin e parandalimit.
- g) Të alokohen fonde respektive për shtimin e organikës dhe përmbushjen e vakancave (nëse ka) pranë IML-së, për sa kohë që konkluzionet e akt-ekspertimeve toksikologjike vonojnë në kohë dhe ndikojnë në vendimmarrjen ndaj shtetasve të privuar nga liria.

h) Nisur nga perfeksionimi i mënyrës së veprimit nga organizatat kriminale dhe pamundësia e ekzekutimit të masave të sigurimit ndaj drejtuesve të tyre (shpesh herë), sugjerojmë marrjen e hapave konkretë për analizimin e trendeve dhe dinamikës së këtyre figurave të veprave penale, si dhe diskutimin mbi impaktin e fenomenit dhe domosdoshmërinë e hetimit dhe gjykimit pa vonesa.